

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6088  
E shtunë, 15 gusht 2020  
çmimi 0.40 €

## OVLUÇK-ja dorëzon kërkesën për ndryshimin e ligjit për Gjykatën Speciale

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

SHBA-ja UA NIS FTESAT KOSOVËS DHE SERBISË PËR TAKIMIN E UASHINGTONIT

FAQE 4-5

# KOSOVA DHE SERBIA SHKOJNË NË SHTËPINË E BARDHË MË 2 SHTATOR



I dërguari i posaçëm i presidentit amerikan për bisedimet Kosovë - Serbi, Richard Grenell, i ka ftuar liderët e Kosovës dhe të Serbisë për takimin e radhë në Uashington. Ai ka bërë me dije se

ndihet i lumtur që këto dy vende do të takohen në Shtëpinë e Bardhë për negociatë. Përfaqësuesit e të dy shteteve kanë mirëpritur ftesat për takim, duke treguar se temë diskutimi do të

jetë bashkëpunimi ekonomik. Zyrtarët më të lartë të Kosovës kanë falënderuar ShBA-në për angazhimin e saj në këtë proces. Sipas tyre, Kosova dhe Serbia do të negociojnë si dy shtete të pavarur

## OPINION

**"DESTRUKSIONI KREATIV"  
QË MUNGON NË TREGUN  
EKONOMIK E POLITIK  
TË KOSOVËS** F. 11

Shkruan:  
Fadil SAHITI



## AKTUALE

**KUVENDI MIRATON LIGJIN PËR  
PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN  
E PANDEMISË** F. 7

**QEVERIA MIRATON VENDIMIN  
PËR HAPJEN E KUFIJVE  
SHTETËRORË ME VENDET  
FQINJE** F. 6

**NËNTOGERI KLEVIS ELEZAJ  
DIPLOMON NË AKADEMINË  
MBRETËRORE USHTARAKE TË  
BRITANISË** F. 6

## EKONOMI

**RRITET PËR 4 PËR QIND  
KONSUMI I ENERGJISË  
ELEKTRIKE NË KOSOVË** F. 9

**DOGANA KONFISKON  
65 MIJË EURO TË  
KONTRABANDUARA** F. 9

**BORDI I POSTËS I KOSOVËS  
EMËRON DY ZYRTARË NË POZITA  
TË LARTA DREJTUESE** F. 9

## SPORT

**TOPALLI, PAS TRANSFERIMIT  
NË TUROI: ËSHTË DASHUR  
SHUMË SAKRIFICË PËR TË  
ARRITUR DERI KËTU** F. 16

## DEPUTETËT I KËRKOJNË PËRGJEGJËSI QEVERISË PËR RASTIN E KARAÇEVËS



Deputetët e Kuvendit të Kosovës e kanë dënuar hyrjen e xhandarmërisë në territorin e Kosovës, duke e cilësuar provokim të rrezikshëm të Serbisë bërë Kosovës. Për këtë rast, deputetët i kanë kërkuar përgjegjësi qeverisë. Ndërsa

ministri i MPB-së, Agim Veliu, ka bërë me dije se është duke kompletuar informacionet rreth hyrjes së xhandarmërisë serbe në territorin e Kosovës. Ai ka paralajmëruar se kjo çështje do të diskutohet edhe në mbledhjen e Këshillit të Sigurisë

FAQE 3

**COVID-19 NË KOSOVË: TETË TË VDEKUR,  
201 TË SHËRUAR DHE 142 RASTE TË REJA**

FAQE 7



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Curëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)



NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË



**Kolegji  
BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
[info@kolegji.biznesi.com](mailto:info@kolegji.biznesi.com)  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

Endrit Shaqiri  
+38344685122

**INFINITY**  
Digital Agency  
Internet Website,  
Marketing...

## Presidenti Meta ia kthen Kuvendit ligjin që ndan Shqipërinë në katër rajone

TIRANË, 14 GUSHT - Pa kaluar 24 orë, presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka kthyer një tjetër ligj për rishqyrtim në Kuvend, atë për zhvillimin rajonal dhe kohezionin, i cili propozon ndarjen e vendit në katër rajone. Sipas Metës, ky ligj bie ndesh me Kushtetutën, Ligjin për Vetëqeverisjen Vendore dhe atë për Ndarjen Administrative-Territoriale. "Kjo ndarje antikushtetuese dhe arbitrare, kufizon direkt çdo iniciativë që mund të kenë dhe ndërmarrin, në bazë të Kushtetutës dhe të



ligjit, organet e qeverisjes vendore për të vendosur vetë për problemet që hyjnë në juridiksionin e tyre. Ky akt

ligjëron ushtrimin e pushtetit politik të pakontrolluar mbi qeverisjen vendore, çka thellon edhe më shumë krizën e rëndë politike dhe kushtetuese në të cilën ndodhet sot vendi ynë", ka thënë Meta.

Presidenti Meta në argumentin e tij ligjor ka thënë se ky akt i miratuar njëkohësisht me ndryshimet kushtetuese dhe ato në Kodin Zgjedhor, synon parapërgatitjen e qeverisë për t'i centralizuar të gjitha burimet financiare dhe ekonomike në ato zona që u

nevojiten, për dhënien e përparësive në funksion të betejave politike. "Krijon struktura paralele, vetëm për ta rritur pushtetin politik të qeverisë dhe për të kontrolluar çdo vendimmarrje deri në nivel vendor", është shprehur Meta. Në listën e argumenteve, Meta ka renditur si argument edhe faktin se konsultimi për ligjin është bërë gjatë kohës së fatkeqësisë natyrore. Ligji i miratuar në seancën plenare të 30 korrikut është denoncuar si antikushtetues edhe nga Partia Demokratike.

## Basha thotë se Shqipëria është në prag të katastrofës



TIRANË, 14 GUSHT - Kryetari i Partisë Demokratike (PD), Lulzim Basha, ka thënë se vendi ndodhet në situatë katastrofike sa i përket situatës me pandeminë dhe ekonominë. Sipas tij, të vetmit që po kujdesen për qytetarët janë mjekët dhe infermierët, ndërsa qeveria i ka braktisur duke mos pasur asnjë plan. Lideri i opozitës shqiptare ka akuzuar qeverinë Rama se nuk ka asnjë plan për t'u ardhur në ndihmë qytetarëve të prekur nga koronavirusi, por edhe të goditur ekonomikisht. Basha ka deklaruar se kriza e pandemisë dhe kriza ekonomike po rëndohen çdo ditë, ndërsa mjekët dhe

infermierët janë sot të vetmit që kujdesen për qytetarët. "Në kulmin e pandemisë, kur numri i të infektuarve dhe atyre që humbin jetën po rriten frikshëm, kryeministri nuk ka asnjë plan për t'u ardhur në ndihmë qytetarëve dhe ekonomisë, asnjë strategji për pandeminë, asgjë përveç propagandës dhe heshtjes apo sulmeve trashanike ndaj çdokujt, që kërkon transparencë dhe veprim", ka deklaruar Basha.

Basha ka deklaruar se situata në rrethe është katastrofike, duke shtuar se qytetarët i blejnë vetë aparaturat e oksigjenit. "Censura për atë çka po ndodh realisht, gënjeshtat

e përsëritura për hapjen e spitaleve të reja Covid, pamjet e rënda të familjarëve që sigurojnë aparatura dhe medikamente për të afërmit e tyre të shtruar në spital, janë pasqyra e qartë e dështimit të qeverisë përballë pandemisë", ka deklaruar ai. Sipas Bashës, mosveprimi dhe mungesa e masave për t'i mbrojtur spitalet dhe qendrat shëndetësore, i ktheu ato në vatra të rrezikshme të përhapjes së virusit. Shqiptarët, ka deklaruar ai, po kalojnë ditët me ankthin e kërcënimit ndaj shëndetit, me frikën e humbjes së vendit të punës dhe pamundësisë që i kërcënon çdo ditë.

## Pastrimi i parave dhe terrorizmi / Shqipëria, vendi i dytë me riskun më të lartë në Evropë

TIRANË, 14 GUSHT - Shqipëria vazhdon të mbetet një vend me risk të lartë sa i përket pastrimit të parave. Pas Moneyvalit, edhe indeksi i vitit 2020 i Institutit të Bazelit e rendit Shqipërinë si vendin evropian me pikëzimin më negativ sa i takon riskut të pastrimit të parave dhe terrorizmit, duke lënë pas vetëm Turqinë.

Në bazë të raportit, Shqipëria zë vendin e 44 mes 141 vendeve duke marrë vetëm 5.69 pikë, teksa Turqia ndodhet tri pozicione më keq se ne duke u renditur e 41-a me 5.76 pikë. Nga vendet e Ballkanit Perëndimor, Bosnjë-Hercegovina renditet e 47 me një klasifikim më të mirë sesa vendi ynë dhe më pas vjen Serbia në vendin e 54. Maqedonia renditet te vendet me riskun e ulët të pastrimit të

parave dhe terrorizmit me 3.98 pikë dhe në vendin e 117, Kroacia në vendin e 119 dhe Mali i Zi në vendin e 126 ndjekur nga Greqia në vendin e 127 dhe Sllovenia në vendin e 133.

Indeksi rendit Afganistanin dhe Haitin si dy vendet me riskun më të lartë të pastrimit të parave, ndërsa Estonia dhe Malta me riskun më të ulët. Për raportin reagoi edhe opozita, e cila thotë se vendi ynë ofron mundësi të arta për grupet kriminale dhe organizatat terroriste që pastrojnë paratë e tyre. Pavarësisht prej paralajmërimeve të ndërkombëtarëve, sipas selisë blu, qeveria shqiptare nuk ka hequr dorë nga përpjekjet për ta miratuar në shtator Ligjin për Amnistinë Fiskale dhe Penale të Parave të Pista.



# Deputetët i kërkojnë përgjegjësi qeverisë për rastin e Karaçevës

Deputetët e Kuvendit të Kosovës e kanë dënuar hyrjen e xhandarmërisë në territorin e Kosovës duke e cilësuar provokim të rrezikshëm të Serbisë për Kosovën. Për këtë ata i kanë kërkuar përgjegjësi qeverisë. Ndërsa ministri i MPB-së, Agim Velju, ka bërë me dije se është duke kompletuar informacionet rreth hyrjes së xhandarmërisë serbe në territorin e Kosovës. Ai ka paralajmëruar se kjo çështje do të diskutohet edhe në mbledhjen e Këshillit të Sigurisë

## "Epoka e re"

PRISHTINË, 14 GUSHT - Deputetët e Kuvendit të Kosovës të premtën i kanë kërkuar përgjegjësi qeverisë për hyrjen e xhandarmërisë serbe në Kosovë. Derisa deputetët e LDK-së e kanë paraqitur këtë si çështje teknike që ndodh që 20 vjet, ata të tri partive të tjera parlamentare e konsideruan këtë si shkelje të sovranitetit të vendit dhe rrezik për destabilizim.

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Artan Abrashi, ka akuzuar kryeministrin Avdullah Hoti për mosndërmarrjen e asnjë veprimi pas këtij incidenti që, sipas tij, është më i rëndi që nga viti 2012. "Kushtetuta në të cilën thirrej me plot gojë Avdullah Hoti më 7 gusht u bë copë-copë dhe u shkel rëndë në mes të ditës. Hyrja e personave të uniformuar është një nga incidentet më të rënda që nga viti 2012. Ky është një provokim i hapur, cenim i integritetit, cenim i sovranitetit shtetëror dhe shkelje e së drejtës ndërkombëtare. Ky incident,

më shumë se incident i sigurisë, është diplomatik dhe duhet të shihet në këtë rrafsh në raport me dialogun. Por kjo qeveri nuk bëri asnjë hap as në rrafshin e sigurisë, aq më pak diplomatik", ka deklaruar ai.

Edhe deputetja e PDK-së, Ganimete Musliu, ka deklaruar se hyrja e xhandarmërisë në territorin e Kosovës paraqet një provokim të rrezikshëm të Serbisë për Kosovën. "PDK-ja është thellësisht e shqetësuar nga shkelja flagrante e sovranitetit territorial të Kosovës nga xhandarmëria serbe e cila jo rrallëherë po synon të shkaktojë konflikt që askush nuk do të dëshironte. Hyrja e xhandarmërisë serbe në atë zonë dhe kontrollet që i bëjnë janë kërcënim për qytetarët e Karaçevës në veçanti dhe Kosovës të në përgjithësi. PDK-ja më shqetësues e shih faktin se qeveria dhe institucionet nuk e kanë prishur komoditetin, e kanë neglizhuar dhe kaluar në heshtje këtë provokim", ka deklaruar ajo. Ndërsa deputeti i AAK-së, Bekë Berisha, ka kërkuar që ky incident mos të relativizohet



nga askush. Ai ka kritikuar ministrat që mbulojnë sektorin e sigurisë për mosraportim para Kuvendit. "Incidenti ndërkufitar me Serbinë nuk bën të relativizohet nga askush. Qofshin nga ata që janë në qeveri apo opozitë. Pavarësisht se kush është në detyrë, nëse i kanë marrë detyrat, këta persona atëherë të përballen me përgjegjësi. Ndonjëherë

duhet dhënë përgjegjësi, besa shpesh, sidomos njerëzit që i kemi zgjedhur për këto detyra", është shprehur Berisha.

Por, shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Arben Gashi, këtë e konsideron si teknikë që veprohet tash e 20 vjet. "Kjo hyrje është bërë në bashkëpunim dhe patrullim me forcat paqeruajtëse të NATO-s. Kjo përsëritet që 20

vjet sepse edhe forcat e NATO-s kalojnë në anën tjetër, pra është çështje teknike. E dimë që është problem një pjesë e kufirit të Kosovës. Ky është problem, por ejani ta zgjidhim. Jo të ndërtojmë kauza dhe akuzat të paqena me qëllim se ta fitojmë opinionin publik përkohësisht, por besoni se nuk e fitoni", ka deklaruar Gashi.

## Velju paralajmëron mbledhjen e Këshillit të Sigurisë për rastin në Karaçevë

Ministri i Punëve të Brendshme, Agim Velju, ka bërë me dije se është duke mbledhur informacionet rreth hyrjes së xhandarmërisë serbe në territorin e Kosovës. Ai ka paralajmëruar se kjo çështje do të diskutohet edhe në mbledhjen e Këshillit të Sigurisë. "Unë jam duke e kompletuar informacionin në tërësi se çka ka ndodhur në Karaçevë. E kam pasur një takim me komandantin e KFOR-it me të cilin e kam diskutuar situatën dhe i kam marrë

informacionet e drejtpërdrejta nga ai. Po presim një mbledhje të Këshillit të Sigurisë Kombëtare në të cilën do ta diskutojmë situatën e krijuar dhe çfarë ka ndodhur në Karaçevë. Pas kompletimit të të gjitha informacioneve, unë sigurisht do të raportoj në komisionin parlamentar. Nëse është e nevojshme, edhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës", ka thënë Velju në një konferencë për media, pas takimit me kryetarin e Pejës, Gazmend Muhaxheri.

# OVLUÇK-ja dorëzon kërkesën për ndryshimin e ligjit për Gjykatën Speciale

PRISHTINË, 14 GUSHT - Organizata e Veteranëve e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK) ka kërkuar nga grupet parlamentare në Kuvendin e Kosovës që ta ndryshojnë ligjin për Gjykatën Speciale. Nën kryetari i kësaj organizate, Nasim Haradinaj, ka thënë se ata kërkojnë që përmes amendamentimit të këtij ligji, Gjykata Speciale t'i hetojë të gjitha krimet që kanë ndodhur në Kosovë. "Përpos asaj, kërkojmë që kjo gjykatë të ketë një zyrë në Kosovë sikurse e ka edhe në Serbi. Kemi kërkuar, gjithashtu, që në emërtimin që ndodhet në objektin e kësaj Gjykate në Hagë, të jenë edhe simbolet e Kosovës. Një kërkesë tjetër është që Organizatës së Veteranëve t'i mundësohet me ligj monitorimi i Zyrës për



Koordinimin e Mbrojtjes Juridike për të Akuzuarit Potencialë nga Dhomat e Specializuara dhe Prokurori Special", ka thënë Haradinaj në një konferencë për media, pasi e ka dorëzuar kërkesën në Kuvendin e Kosovës. Kuvendi i Kosovës e miratoi ligjin për formimin e Gjykatës

Speciale në gusht të vitit 2015. Drejtues të Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës disa herë e kanë quajtur "raciste dhe të njëanshme" këtë gjykatë pasi, sipas tyre, ajo nuk do t'i hetojë edhe krimet serbe në Kosovë. Gjykata është themeluar pas raportit të Këshillit të Evropës, të

vitit 2011, në të cilin senatori zviceran Dick Marty flet për krimet e pretenduara "të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ndaj pakicave etnike dhe rivalëve politikë", që nga janari i vitit 1998 e deri në dhjetor të vitit 2000.

Në muajin dhjetor të vitit 2017, 43 deputetë të përbërjes së atëherëshme të Kuvendit të Kosovës kishin parashtruar kërkesë për seancë të jashtëzakonshme për shfuqizimin e Ligjit për Gjykatën Speciale. Kryesia e Kuvendit e Kosovës kishte dështuar dy herë që ta sigurojë kuorumin për shqyrtimin e kërkesës së 43 deputetëve. Lidhja Demokratike e Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje dhe Lista Serbe nuk i patën dërguar përfaqësuesit e tyre në mbledhjen e Kryesisë, me çka e

kishin pamundësuar kuorumin për vendimmarrje. Komuniteti ndërkombëtar kishte bërë trysni që kjo nismë të mos procedohet. Deri më tani prokurorët kanë intervistuar qindra ish-pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Më 24 qershor Zyra e Prokurorit të Specializuar ka njoftuar se më 24 prill ka paraqitur një aktakuzë për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit kundër presidentit Thaçi, kryetarin të PDK-së, Kadri Veseli, dhe disa të tjerëve, emrat e të cilëve nuk janë bërë publikë. Gjykatësi i procedurës paraprake ka maksimum gjashtë muaj kohë, nga muaji prill, për të konfirmuar ose hedhur poshtë aktakuzën. Presidenti Thaçi dhe kryetari i PDK-së, Kadri Veseli, tashmë janë intervistuar nga ana e prokurorëve.

ShBA-ja ua nis ftesat Kosovës dhe Serbisë për takimin e Uashingtonit

# Kosova dhe Serbia shkojnë në S

I dërguari i posaçëm i presidentit amerikan për bisedimet Kosovë - Serbi, Richard Grenell, i ka ftuar liderët e Kosovës dhe të Serbisë për takimin e radhë në Uashington. Ai ka bërë me dije se ndihet i lumtur që këto dy vende do të takohen në Shtëpinë e Bardhë për negociata. Përfaqësuesit e të dy shteteve kanë mirëpritur ftesat për takim, duke treguar se temë diskutimi do të jetë bashkëpunimi ekonomik. Zyrtarët më të lartë të Kosovës kanë falënderuar ShBA-në për angazhimin e saj në këtë proces. Sipas tyre, Kosova dhe Serbia do të negociojnë si dy shtete të pavarur



Zëdhënësja e BE-së rikujtoi se rruga drejt bllokut evropian për Kosovën dhe Serbinë kalon përmes dialogut të ndërmjetësuar nga Brukseli. Në fund të këtij muaji në Bruksel pritet të zhvillohet edhe një takim ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në kuadër të dialogut në nivel të ekspertëve, ndërsa në fillim të shtatorit do të zhvillohet edhe një raund i bisedimeve ndërmjet kryeministrit të Kosovës, Avdullah Hoti dhe presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq.

## Kurti takimin e 2 shtatorit e lidh me fushatën zgjedhore në ShBA

Jo të gjithë liderët politikë në Kosovë e kanë mirëpritur ftesën e Grenellit për takimin në Shtëpinë e Bardhë. Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, këtë takim e ka ndërlidhur me zgjedhjet presidenciale që do të mbahen në Amerikë. Ai ka kritikuar qasjen e Grenellit ndaj këtij procesi, duke thënë se ai do një sukses të orëve të fundit në politikën e jashtme. "Rreth 80 ditë kanë ngelur deri te zgjedhjet e reja në ShBA, ku presidenti Donald Trump përballet me kandidatin demokrat Joe Biden. Fushata atje po forcohet ende pa filluar

zyrtarisht. Në këtë kontekst duhet të shihet edhe 2 shtatori si datë e paralajmëruar e negociatave ndërmjet Kosovës e Serbisë në Uashington D. C. Ish-ambasadori amerikan në Berlin dhe ish u. d. i drejtorit të Inteligjencës Nacionale, Richard Grenell, e do një sukses të orëve të fundit në politikën e jashtme. Ai pardje kritikoi Bidenin që 'premtonte se problemet e botës do t'i bëjë përgjegjësi të ShBA-së', kurse sot vetë ai bëri thirrje për negociata midis Kosovës e Serbisë, ka shkruar Kurti në profilin e tij në "Facebook". Sipas tij, Grenelli është i njëjti diplomat që thoshte se nuk ka parë e as diskutuar ndonjëherë për "shkëmbim territorial". "Pastaj e akuzonte ish-këshilltarin e Sigurisë Nacionale, John Bolton, se ai paska qenë prapa këtij plani, ndërkaq ky i fundit u përgjigj duke thënë se atë e ka dëgjuar nga dy presidentët, i Kosovës e i Serbisë. Në janar të këtij viti Grenelli ndryshoi pozicionin e deriatëhershëm amerikan dhe braktisi të gjitha kërkesat ndaj Serbisë në raport me Kosovën. Grenelli ia ka mësyre kontestit Kosovë - Serbi si një cowboy i financave dhe mediave që nuk do t'ia dijë për historinë e shqiptarëve dhe vuajtjet e humbjet e Kosovës. Në njoftimin e tij, Grenelli tanimë

nuk flet për dialog, por për negociata. E negociatat kanë për destinim kompromisin", ka vlerësuar Kurti, duke shtuar se Kushtetuta e Kosovës e ka përbrenda kompromisin e dhimbshëm të pakos së Ahtisaarit, ndërkaq Kushtetuta e Serbisë vazhdon synimet e Millosheviqit.

Më tej, Kurti ka thënë se qeveria e vendit në kohë të pandemisë duhet të ketë prioritete të tjera. "Prioritete të Kosovës duhet të jenë luftimi i pandemisë Covid-19, pra dalja nga kriza shëndetësore, luftimi i krimit të organizuar e korrupsionit të lartë, pra drejtësia shtetërore dhe, zhvillimi ekonomik e shoqëror, pra punësimi, sidomos i rinisë dhe grave. Qeveria aktuale e Kosovës po dështon në secilin rrafsh. Sa i përket Serbisë, ne mund të dialogojmë si shtete fqinje, bazuar në parimin e reciprocitetit dhe pas përgatitjeve të duhura e me transparencë të plotë. Ata që nga Kosova po duan të shkojnë në këto negociata të thirrura për 2 shtator nuk kanë legjitimitet, kredibilitet, autoritet e as kompetencë. Rrjedhimisht, marrëveshjet e tyre janë të pazbatueshme dhe nuk vlejnë as sa çmimi i letërës ku shkruhen", është shprehur Kurti.

**EPOKA E RE** **Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 14 GUSHT** - Më 2 shtator liderët e Kosovës dhe të Serbisë do të takohen në Uashington me ndërmjetësimin e Shteteve të Bashkuara për vazhdimin e negociatave për normalizim të marrëdhënieve. Këtë e ka bërë me dije i dërguari i posaçëm i presidentit amerikan për bisedimet Kosovë - Serbi, Richard Grenell. "Jemi të lumtur të njoftojmë se liderët e Kosovës dhe të Serbisë do të takohen në Shtëpinë e Bardhë për negociata më 2 shtator", ka shkruar Grenell në llogarinë e vet në "Twitter".

Liderët institucionalë të Kosovës i janë përgjigjur pozitivisht kësaj ftese duke shprehur mirënjohjen ndaj ShBA-së për kontributin që po jep në këtë proces. Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka mirëpritur caktimin e datës për takimin mes Kosovës dhe Serbisë në Uashington. "E mirëpres takimin e paralajmëruar në Shtëpinë e Bardhë për bisedimet midis Kosovës dhe Serbisë. Ne jemi mirënjohës ndaj ShBA-së për përkushtimin e jashtëzakonshëm për paqen dhe stabilitetin në rajon", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Twitter".

Ndërsa kryeministri Avdullah Hoti ka vlerësuar se më 2 shtator Kosova dhe Serbia do të takohen si dy vende të pavarura, për projekte madhore të bashkëpunimit ekonomik. "ShBA-ja ka qenë gjithmonë vendimtare në procesin e shtetndërtimit të Kosovës. Më 2 shtator takohemi në Shtëpinë e Bardhë për të diskutuar me palën serbe, si dy vende të pavarura, për projekte madhore të bashkëpunimit ekonomik që do ta ndërrojnë perspektivën ekonomike të Kosovës dhe rajonit. Kosova është e bekuar

me miqtë që ka", ka shkruar Hoti në profilin e tij në "Facebook". Takimin e ka përshëndetur edhe kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, i cili ka thënë se Kosovës i duhet roli udhëheqës i Amerikës për arritjen e marrëveshjes finale me Serbinë, njohjen reciproke në kufijtë ekzistues. "Përshëndes liderhipin amerikan në ndërmjetësimin për Deklaratën e Përbashkët mes Izraelit dhe Emirateve të Bashkuara Arabe. Kosovës i duhet roli udhëheqës i Amerikës për arritjen e marrëveshjes finale me Serbinë, njohjen reciproke në kufijtë ekzistues", ka shkruar Haradinaj.

## BE-ja: Mbështetja e ShBA-së, e mirëseardhur

Bashkimi Evropian i konsideron Shtetet e Bashkuara të Amerikës partner i rëndësishëm në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, pasi thotë se ndajnë qëllimet e njëjta në rajon. Kështu ka reaguar BE-ja ndaj njoftimit për takimin e liderëve të Kosovës dhe Serbisë, i thirrur për 2 shtator në Shtëpinë e Bardhë.

Nabila Massrali, zëdhënëse e BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, ka thënë se e kanë marrë këtë njoftim të Shtëpisë së Bardhë, duke rikujtuar se mbështetja e ShBA-së në dialogun e lehtësuar nga BE-ja është e mirëseardhur. "Kur është në pyetje përfshirja e palëve të treta në përpjekjet për t'i ndihmuar Kosovën dhe Serbinë që të pajohen për një normalizim gjithëpërfshirës të raporteve të tyre, ne mirëpresim nismat që mbështesin dialogun e lehtësuar nga BE-ja. Në këtë drejtim ne kemi marrë njoftimin e ambasadorit Grenell", ka thënë për Radion Evropa e Lirë, Nabila Massrali.

# htëpinë e Bardhë më 2 shtator



## Vuçiq: Serbia nuk është në pozicion që ta refuzojë këtë takim

Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka konfirmuar pjesëmarrjen në takimin e 2 shtatorit në Uashington, të cilin e ka thirrur emisari special i Shtëpisë së Bardhë, Richard Grenell. "Serbia nuk është në pozicion që të refuzojë këtë takim, apo ndonjë tjetër", ka deklaruar presidenti serb, duke shtuar se temë e takimit do të jetë ekonomia. "Në negociata marrin pjesë. Temë do të jetë ekonomia. Kjo

është e rëndësishme për ne dhe është temë e mirë", ka thënë Vuçiqi, raporton "B92". Nga këndvështrimi i amerikanëve, dy shtete të pavarura po marrin pjesë në negociata, ka thënë Vuçiqi dhe kjo, është sipas tij, "se si Brukseli na shikon neve". Presidenti serb është shprehur dyshues nëse udhëheqësit e shtetit të Kosovës do të jenë në Uashington vetëm për çështjet ekonomike.

## KDI: Kosova ta ndërtojë konsensusin politik për dialogun para takimit në Uashington

Instituti Demokratik i Kosovës ka vlerësuar se është i domosdoshëm që në Kosovë të ndërtohet konsensus politik para se të shkohet në Uashington për dialog me Serbinë më 2 shtator. "Në kuadër të procesit të normalizimit, Kosova dhe Serbia janë duke zhvilluar takime të vazhdueshme të cilat kanë për synim arritjen e një marrëveshje gjithëpërfshirëse, ligjrisht të obligueshme. Pavarësisht prej gatishmërisë dhe mbështetjes nga spektri politik për procesin përmbyllës të dialogut, mungesa e konsensusit politik lidhur me përfaqësimin e Kosovës në bisedime po vazhdon ta karakterizojë pozicionin e saj negociues", është thënë në komunikatën e KDI-së. KDI ka kërkuar nga Qeveria e

Kosovës që sa më parë t'i shtojë përpjekjet për arritjen e konsensusit sa më të gjerë në mes të spektrit politik, lidhur me të gjitha çështjet e ndërlidhura me dialogun për arritjen e marrëveshjes përfundimtare me Serbinë. "Ne vlerësojmë se kjo çështje duhet të trajtohet përtej kalkulimeve politike ditore, andaj si partitë në pushtet edhe ato në opozitë duhet të tregojnë përkushtim dhe konstruktivitet për t'i tejkaluar pengesat në arritjen e pajtueshmërisë politike rreth procesit, para takimit të paralajmëruar në Uashington. Çdo vonesë në këtë drejtim rrezikon ta dëmtojë pozitën e Kosovës në bisedime si dhe marrëdhëniet e saj me partnerët ndërkombëtarë", është thënë në komunikatë.


## Çitaku i shkruan Grenellit: Faleminderit!

Ambasadorja e Kosovës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Vlora Çitaku, ka përhëndetur dhe falënderuar zyrtarët amerikanë për caktimin e një date të re për takimin në mes të Kosovës e Serbisë në Uashington. Ajo ka falënderuar Grenellin dhe asistentin e presidentit amerikan për Çështje të Sigurisë Kombëtare, Robert C. O'Brien, për mbështetjen që po i japin dialogut. "Richard Grenell dhe Robert C. O'Brien vetëm sa lajmëruan ftesat për vazhdimin e dialogut Kosovë - Serbi. Faleminderit që po vërtetoni se vendet e lira dhe demokratike gjithmonë mund të llogarisin në Shtetet e Bashkuara të Amerikës", ka shkruar Çitaku në "Twitter".

## Haradinaj-Stubulla: Marrëveshja Kosovë - Serbi të arrihet sa më parë, me ndërmjetësimin e ShBA-së

PRISHTINË, 14 GUSHT (ER) - Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës e Republikës së Kosovës (MPJD) ka përhëndetur marrëveshjen historike të arritur midis Izraelit dhe Emirateve të Bashkuara Arabe (EBA). "Përhëndesim marrëveshjen historike për normalizimin e marrëdhënieve diplomatike ndërmjet Izraelit dhe Emirateve të Bashkuara Arabe të ndërmjetësuar nga presidenti Trump", ka thënë Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Meliza Haradinaj-Stublla, sipas një komunikate për medie të MPJD-së. Kryediplomatja e Kosovës ka

thënë se kjo marrëveshje trepalëshe është hap i madh përpara për krijimin e energjive të reja që do të sjellin ndryshime të mëdha në proceset e paqëbërjes dhe zhvillimit në Lindjen e Mesme. "Marrëveshja historike e arritur nën ndërmjetësimin dhe liderhipin amerikan është dëshmi e fuqishme e përkushtimit të liderëve të Izraelit dhe Emirateve të Bashkuara Arabe, për paqe dhe zhvillim", ka thënë Ministria Haradinaj-Stublla, duke shtuar se edhe marrëveshja përfundimtare Kosovë - Serbi duhet të arrihet sa më parë, me ndërmjetësimin e ShBA-së.



## Nëntogeri Klevis Elezaj diplomon në Akademinë Mbretërore Ushtarake të Britanisë

PRISHTINË, 14 GUSHT - Forca e Sigurisë e Kosovës (FSK) ka shënuar edhe një sukses në një prej akademive më prestigjioze ushtarake në botë. Kësaj radhe ky sukses vjen nga nëntogeri Klevis Elezaj, i cili ka përfunduar me sukses trajnimin njëvjeçar në Akademinë Mbretërore Ushtarake Sandhurst në Britaninë e Madhe. Ai ka diplomuar të premtën, e pas ceremonisë së diplomimit ka treguar se do të kthehet ta vazhdojë shërbimin në FSK dhe do ta përcjellë tek ushtarët përvojën profesionale të marrë në Sandhurst. "Trajnimi njëvjeçar në këtë akademi ka qenë mjaft sfidues duke marrë parasysh rezistencën psikike, përgatitjen dhe kalitjen fizike, gjithashtu përgatitjen

ushtarake dhe strategjike që e kemi marrë në Sandhurst. Kjo është shumë fitimprurëse për ushtinë tonë për arsye se oficerët tanë që shkollohen këtu trajnohen dhe mësojnë një doktrinë e cila është prej doktrinave më të mira në botë për udhëheqje, lidhshmëri ushtarake dhe strategji ushtarake", ka thënë nëntogeri Elezaj për "Kosovapress".

Nëntogeri Klevis Elezaj ka theksuar se periudha e shkollimit ka qenë mjaft atraktive për të, ku ka theksuar se është pritur mjaft mirë nga britanikët prej të cilëve thotë të ketë marrë shumë njohuri. "Unë kthehem në Kosovë me regjimentin e dytë si toger i këmbëorisë, aty do të vazhdoj dhe jap kontributin tim të trajnimit të ushtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës në



ngritjen e tyre në nivelet e ushtrisë së NATO-s", është shprehur ai.

Në këtë akademi sivjet kanë nisur shkollimin edhe dy pjesëtarë të

FSK-së dhe me herët kanë diplomuar dhjetëra të tjerë.

## Qeveria miraton vendimin për hapjen e kufijve shtetërorë me vendet fqinje

PRISHTINË, 14 GUSHT (ER) - Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për hapjen e kufijve shtetërorë të Republikës së Kosovës me Republikën e Shqipërisë, Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe me Republikën e Serbisë. Në këtë mbledhje, kabineti qeveritar i ka proceduar Kuvendit të Republikës së Kosovës mendimin lidhur me nismën legislative për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për festat zyrtare në Republikën e Kosovës. Në mendimin e qeverisë janë përfshirë opinionet e Ministrisë së Financave dhe Departamentit të së Drejtës së BE-së. Sipas procedurave përkatëse, të gjitha institucionet e lartcekura i kanë përcjellë opinionet dhe



deklaratat e tyre sipas fushëveprimit përkatës. Në rrjedhë të kësaj, Qeveria e Republikës së Kosovës e vlerëson nismën legislative të

inicuar nga deputetët propozues të Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e

Ligjit për festat zyrtare në Republikën e Kosovës, nëpërmjet së cilës krijohet baza ligjore për shënimin e Ditës së Egjiptianëve më 24 qershor, si

ditë përkujtimore. Qeveria e ka konsideruar të nevojshme që ky projektligj duhet të plotësohet dhe ndryshohet dhe neni 4 të fshihet në tërësi dhe të riformulohet si në vijim: "Kur ditët e festave zyrtare të cekura në nenin 2 të këtij ligji bien ditën e shtunë ose të diel, nuk do të jenë ditë pushimi ditët pasardhëse të punës". Gjithashtu, mendimi i qeverisë është proceduar në Kuvendin e Republikës së Kosovës edhe për nismën legislative për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës. Në këtë mbledhje qeveria ka miratuar projektligje, vendime dhe dokumente të tjera të fushës së përgjegjësisë kushtetuese dhe ligjore.

## Hoti dhe Jasharaj diskutojnë për fillimin e vitit të ri shkollor

PRISHTINË, 14 GUSHT (ER) - Kryeministri Avdullah Hoti ka zhvilluar një takim virtual me kryetarin e Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), Rrahman Jasharaj, me të cilin janë pajtuar për komunikim të vazhdueshëm lidhur me përgatitjet që po bëhen për fillimin e vitit të ri shkollor.

Në llogarinë e vet në "Facebook", Hoti ka shkruar se vendimi final për mënyrën e organizimit të mësimit do të merret duke pasur parasysh sigurimin e cilësisë në mësim dhe shëndetin e nxënësve.

"Sot me kryetarin e SBASHK-ut, z. Rrahman Jashari, u pajtuam për komunikim të vazhdueshëm lidhur me përgatitjet që po bëjmë për fillimin e vitit të ri shkollor. Ministri Likaj dhe ekipi i tij janë duke i bërë përgatitjet e nevojshme pas konsultimit të gjerë që kishim me kryetarët e komunave. Vendimi final për mënyrën e organizimit të mësimit do të merret duke pasur parasysh konsideratat për sigurim të cilësisë në mësim, mbi të gjitha shëndetin e nxënësve, stafit mësimdhënës dhe stafit tjetër mbështetës", ka shkruar Hoti.



# Covid-19 në Kosovë: Tetë të vdekur, 201 të shëruar dhe 142 raste të reja



Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se në 24 orët e fundit kanë vdekur tetë persona të cilët kanë qenë të infektuar me Covid-19. Po ky institut ka bërë me dije se gjatë këtyre orëve janë shëruar 201 persona dhe janë paraqitur 142 raste të reja me virusin "Korona". Ndërsa ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, gjatë raportimit të Komisionin për Shëndetësi, ka thënë se situata me pandeminë në vendin tonë është e menaxhueshme

komuna Lipjan 2 raste, komuna Rahovec 2 raste, komuna Skenderaj 2 raste, komuna Suharekë 2 raste dhe me nga një rast komunat Kaçanik dhe Viti", ka njoftuar IKShPK-ja.

## Zemaj: Situata me pandeminë është e menaxhueshme

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka bërë me dije se situata me pandeminë Covid-19 është e menaxhueshme. Gjatë raportimit në Komisionin Parlamentar për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Zemaj ka treguar për hapat që ka marrë si ministër në përballjen me Covid-19. "Kemi bërë hapa para. Këtë javë kemi hartuar edhe protokollin e ri klinik i cili është i rëndësishëm për menaxhimin e Covid dhe besojmë se ky udhërrëfyes klinik synon t'i trajtojë personat e dyshimtë. Sot kemi një nivel ndryshe të trajnimit të pacientëve dhe të gjithë personave në gjithë Kosovën. Me lirimin e masave është parë e domosdoshme rritja e kapaciteteve spitalore, kemi autorizuar edhe spitalet rajonale të ofrojnë këtë shërbim dhe në numër të kon-

siderueshme dhe shqetësues është vdekshmëria në të gjitha nivelet", ka thënë ai. Para deputetëve, Zemaj ka treguar se synohet që brenda ditës të bëhen deri në 3 000 teste falas. "Nëse brenda institucioneve tona shëndetësore, saktësisht gjashtë qendrave tona rajonale, si dhe në Institutin e Shëndetësisë

Publike, ashtu edhe në Klinikën Infektive, ofrojmë laboratorë ku kryhen testime, atëherë do ta arrijmë maksimumin e kryerjes së testimeve, duke mbuluar kështu nevojat e qytetarëve. Sipas planifikimeve që kemi bërë, synojmë 3 000 teste në ditë të kryhen falas", është shprehur Zemaj.

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 GUSHT - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) me metodën RT-PCR, janë testuar gjithsej 466 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren prej të cilëve rezultojnë 142 raste pozitive. Në këtë kontekst, IKShPK-ja ka bërë me dije se brenda 24 orëve janë raportuar 8 raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv. "Numri total i rasteve pozitive është 11 130 raste nga 43 093 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe 381 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 201

pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 6 817 raste, kurse numri i rasteve aktive është 3 932", ka njoftuar IKShPK-ja, duke treguar numrin e rasteve pozitive me Covid, sipas komunave. "Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 45 raste, komuna Gjilan 10 raste, komuna Podujevë 10 raste, komuna Pejë 8 raste, komuna Prizren 8 raste, komuna Mitrovicë 7 raste, komuna Gjakovë 5 raste, komuna Vushtrri 5 raste, komuna Fushë Kosovë 5 raste, komuna Ferizaj 4 raste, komuna Deçan 4 raste, komuna Istog 4 raste, komuna Malishevë 4 raste, komuna Drenas 3 raste, komuna Klinë 3 raste, komuna Obiliq 3 raste, komuna Dragash 2 raste, komuna Kamenicë 2 raste,

## Licencohen edhe nëntë laboratorë privatë për kryerje të testeve serologjike

Ministria e Shëndetësisë (MSh) në Kosovë ka njoftuar të premtën se ka licencuar edhe nëntë laboratorë për kryerjen e testeve serologjike për koronavirus. Përmes këtyre testeve, kuptohet nëse një person ka tejkaluar këtë virus, si dhe nëse trupi ka krijuar antitrupe kundër tij. MSh-ja ka thënë se shtrirja e laboratorëve është në shumë qytete të Kosovës, duke përfshirë Prishtinën, Pejën, Gjilanin, Malishevën dhe Vushtrrinë. Ky është njoftimi i katërt që bën kjo ministri për licencim të laboratorëve për kryerje të testeve serologjike. Në rrethin e parë të licencimit, autoritetet kanë thënë se u është dhënë leja e punës edhe dy laboratorëve të tjerë për kryerje të testeve PCR që përcaktojnë nëse virusi është aktiv. Deri më tani ministria ka licencuar 55 laboratorë privatë për testimet për Covid-19.

## Kuvendi miraton ligjin për parandalimin dhe luftimin e pandemisë

Prishtinë, 14 gusht (ER) - Kuvendi i Republikës së Kosovës e ka miratuar në lexim të dytë Projektligjin për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës. Në

favor të këtij projektligji kanë votuar 77 deputetë dhe shtatë të tjerë kanë abstenuar. Ky projektligj është iniciuar nga kryetarja e Kuvendit e Kosovës, Vjosa Osmani, e cila ka falënderuar deputetët për votimin e

këtij projektligji. Me këtë rast, ajo ka përgëzuar veçanërisht anëtarët e Komisionit për Shëndetësi, duke bërë thirrje që të jenë të bashkuar në tema që janë në interes të qytetarëve.



# Rritet për 4 për qind konsumi i energjisë elektrike në Kosovë

Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka bërë me dije se është rritur për 4 për qind konsumi i energjisë elektrike në vendin tonë. Sipas ASK-së, gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020 vlera e gjithëmbarshme e prodhimit të thëngjillit ka qenë rreth 1.96 milion tonë



elektrike. Ndërkaq, sasia e energjisë elektrike për konsum në këtë tremujor ishte 1 043.8 GWh energji elektrike. Në raport me tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar (TM2 2019), sasia e energjisë elektrike e konsumuar është rritur për 0.4 për qind”, ka njoftuar ASK-ja.

**EPOKA E RE**

A. MAVRAJ

**PRISHTINË, 14 GUSHT** - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) publikon “Bilancin i Energjisë” për TM2 2020. Në këtë publikim janë prezantuar të dhënat mbi prodhimin e thëngjillit, të dhënat për prodhimin dhe konsumin e energjisë, importin dhe eksportin e energjisë, si dhe importin dhe eksportin e energjentëve të tjerë. Sipas ASK-së, gjatë tremujorit të

dytë të vitit 2020 (TM2 2020) vlera e gjithëmbarshme e prodhimit të thëngjillit ishte rreth 1.96 milion tonë, kurse sasia bruto e energjisë elektrike e prodhuar në termocentrale ishte 1 512.0 GWh dhe në hidrocentrale rreth 100.2 GWh. “Sa iu përket vlerave të energjisë së importuar, respektivisht të eksportuar, gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020 Kosova ka importuar 509.4 GWh energji elektrike, derisa ka eksportuar 643.1 GWh energji

## KEDS-i po investon afër një milion euro në Pejë

**PRISHTINË, 14 GUSHT (ER)** - Sikurse edhe në qytete të tjera, KEDS-i është duke vazhduar të investojë në modernizimin e rrjetit në Komunën e Pejës. Mbi 12 mijë konsumatorë do të kenë rrjet modern dhe të standardeve më të larta. Vetëm sivjet janë ndarë afër 1 milion euro nga të cilat do të realizohen mbi 22 projekte. Kështu ka njoftuar të premten KEDS-i. “Në rrjetin e tensionit të ulët dhe të mesëm do të shtrihen mbi 7 000 metra kablo dhe do të zëvendësohen mbi 100 shtylla të vjetra me shtylla të reja betoni. Në disa lokacione, shtyllat do të largohen tërësisht, ndërsa rrjeti do të vendoset nën tokë. Përmes këtyre investimeve, po mundësohet modernizimi i tërësishëm i rrjetit në mënyrë që konsumatorët të marrin shërbime kualitative dhe të

sigurta të energjisë elektrike. KEDS edhe gjatë viteve të kaluara ka investuar në shumë projekte në Pejë. Në vitin 2019, KEDS kishte përfunduar instalimet e reja dhe moderne të linjave 35kV, ndërkaq në Deçan kishte përfunduar punimet e vendosjes së kablos alternative, duke krijuar stabilitet dhe siguri shumë më të madhe të furnizimit me rrymë për konsumatorët në rast të ndonjë prishje”, ka njoftuar KEDS-i. Sipas këtij njoftimi, këto investime janë jetësim i përkushtimit të KEDS-it që të jenë sa më afër qytetarëve të Kosovës dhe t’i përmirësojnë në vazhdimësi shërbimet për ta. “Sot, 7 vjet pas, KEDS-i ka investuar rreth 150 milionë euro dhe qindra mijë konsumatorë kanë shërbime dukshëm”, ka njoftuar KEDS-i.



## Dogana konfiskon 65 mijë euro të kontrabanduara

**Prishtinë, 14 gusht (ER)** - Dogana e Kosovës ka njoftuar se të premten në orët e mëngjesit, në vendkalimin kufitar të Merdarit, është zhvilluar një operacion kontrolli ndaj një të qytetari të Kosovës, i cili ka tentuar që në mënyrë të fshehur në veturën e tij të sjellë në Kosovë nga Serbia një sasi të konsiderueshme të parave. Pas zbulimit, shumica e tërësishme

e parave ishte 65 450 euro. “Paratë kanë qenë të fshehura mirë dhe janë detektuar pas përpjekjeve të konsiderueshme të zyrtarëve të antikontabandës. Personi është në mbajtje derisa mjetet monetare janë konfiskuar, si dhe kanë filluar hetimet për këtë rast në bashkëpunim me institucionet e tjera”, ka njoftuar Dogana e Kosovës.



# Riorganizohet Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik

Qeveria e Kosovës ka marrë disa vendime në fushën ekonomike. Në kuadër të këtyre vendimeve, qeveria ka marrë vendim për riorganizimin e Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik të Kosovës. Ky këshill do të kryesohet nga kryeministri, kurse pjesë e tij do të jenë përfaqësues të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare



## KJO ËSHTË PËRBËRJA E KËSHILLIT KOMBËTAR PËR ZHVILLIM EKONOMIK

Po në këtë mbledhje miratimin e qeverisë e ka marrë edhe vendimi për Riorganizimin e Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik të Kosovës. Sipas vendimit, emërtimi ndryshohet në Këshillin Kombëtar për Ekonomi dhe Investime dhe do të përbëhet nga:

Kryeministri, kryesues  
Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit  
Ministri i Tregtisë dhe Industrisë  
Ministrja e Financave  
Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural  
Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale  
Ministri i Arsimit dhe Shkencës  
Ministri i Drejtësisë  
Ministri i Infrastrukturrës  
Ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës  
Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal

Drejtori i përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës  
Drejtori i përgjithshëm i Doganave të Kosovës  
Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Investimeve dhe Përkrahjes së Ndërmarrjeve në Kosovë  
Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës  
Udhëheqësi i Zyrës së Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim në Kosovë;  
Udhëheqësi i Zyrës së Bankës Botërore në Kosovë  
Përfaqësues i Posaçëm i Bashkimit Evropian në Kosovë/Komisionit Evropian;  
Ambasada e ShBA-së në Kosovë/USAID  
Kryetari i Bordit apo drejtori ekzekutiv e Odës Ekonomike të Kosovës  
Kryetari i Bordit apo drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë  
Kryetari i Bordit apo drejtori ekzekutiv i Aleancës Kosovare të Biznesit  
Kryetari i Bordit apo drejtorja ekzekutive e Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare  
Kryetari i Bordit apo drejtori Ekzekutiv i Odës së Afarizmit të Kosovës  
Kryetari i Bordit apo drejtori Ekzekutiv i Këshillit të Investitorëve Evropianë  
Kryetari i Bordit apo drejtori Ekzekutiv i Klubit të Prodhuesve Kosovare  
Kryetari i Bordit apo drejtori Ekzekutiv i Forumit Ekonomik të Grave  
Kryetarja e Bordit apo drejtorja Ekzekutive e Dhomës Ekonomike të Grave të Kosovës-G7  
Kryetari i Bordit apo drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Përpunuesve të Drurit  
Kryetari i Bordit apo drejtori Ekzekutiv i Asociacionit të Komunave të Kosovës.

EPOKA  
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 14 GUSHT - Qeveria e Kosovës ka mbajtur të premtën mbledhjen e radhës korresponduese, në të cilën ka miratuar disa projektligje, vendime dhe dokumente të tjera të fushës së përgjegjësisë kushtetuese dhe ligjore. Në këtë mbledhje, qeveria ka miratuar vendimin për mbulimin e primit të policës së sigurimit kufitar për të gjithë bashkatdhetarët dhe të huajt që hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës. "Qeveria do ta subvencionojë policën e sigurimit njëmuor të lëshuar brenda periudhës 01. 08. 2020 - 31. 12. 2020. Me po këtë vendim është themeluar grupi punues ndërinstitucional për ndërmarrjen e masave të duhura dhe përgatitjen e kushteve për aplikim në kartonin e gjelbër", ka njoftuar Qeveria e Kosovës. Po në këtë mbledhje kabineti qeveritar ka miratuar Raportin për nivelin e ekzekutimit të projekteve të financuara nga

huamarrja ndërkombëtare. "Sipas raportit, gjendja e borxhit publik më datën 30 qershor 2020 ishte 1 miliard e treqind e katërbëdhjetë milionë e njëqind e njëzet mijë euro, prej të cilave 426.62 milionë 137 euro janë borxh ndërkombëtar, ndërsa 884.51 milionë borxh i brendshëm. Kjo përbën 18.17 për qind të Bruto Prodhimit Vendor. Është shqyrtuar dhe miratuar edhe Konceptdokumenti për themelimin e Agjencisë për Integrim Evropian në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Konceptdokumenti analizon situatën e krijuar pas riorganizimit të Qeverisë së Kosovës dhe shuarjes së Ministrisë së Integritimeve Evropiane. Duke vlerësuar se procesi i integritimeve evropiane për shtetin e Kosovës është jetik dhe duke pasur parasysh nevojën e koordinimit të zbatimit të marrëveshjeve të Republikës së Kosovës me Bashkimin Evropian, rekomandohet organizimi i Agjencisë për Integritime Evropiane", ka njoftuar ekzekutivi.



## Bordi i Postës së Kosovës emëron dy zyrtarë në pozita të larta drejtuese

PRISHTINË, 14 GUSHT - Bordi i përkohshëm i drejtorëve të Postës së Kosovës ka mbajtur mbledhjen e radhës në të cilën ka pranuar dorëheqjen e dy zyrtarëve të lartë, atë të ushtruesit të detyrës së kryeshefit ekzekutiv, Salih Morina dhe të zyrtarit kryesor financiar, Enver Govori. Me këtë rast, ky

bord në këto pozita ka emëruar Vjollca Shala-Mulajn dhe Fadil Brestovcin. "Për kontributin e jashtëzakonshëm të z. Morina dhe z. Govori, bordi i përkohshëm i drejtorëve i Postës së Kosovës u shpreh falënderime për gjithë punën e tyre të gjertanishme në këto pozita të larta zyrtare në Postën

e Kosovës. Bordi i përkohshëm i drejtorëve të Postës së Kosovës sot vendosi që në pozitën e u. d të kryeshefit ekzekutiv, emëroi znj. Vjollca Shala-Mulajn, ndërsa në pozitën e zyrtarit kryesor financiar dhe të thesarit, si ushtrues detyre, emëroi z. Fadil Brestovci", ka njoftuar Posta e Kosovës.



# Haziri vlerëson lart rolin e rinisë në mbështetjen e kampanjave anti-Covid

GJILAN, 14 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka pritur në një takim pune të rinjtë e kësaj komune, që janë përfaqësues të organizatave në KVRL, të cilët kanë paraqitur shqetësimet e tyre të ndikimit negativ që kishte pandemia në aktivitetet rinore dhe zhvillimin e këtij sektori. Haziri ka vlerësuar lart rolin e rinisë, e cila vazhdimisht ka qenë e angazhuar në fushatat sensibilizuese anti-Covid, duke u dalë në krahë institucioneve lokale për të kaluar këtë gjendje të rëndë e cila ka shkaktuar regres të madh në të gjithë sektorët e

jetës. Haziri ka kërkuar nga përfaqësuesit e KVRL-së që të jenë më konkurrues me projekte në organizatat vendore dhe ndërkombëtare. "Jam falënderues për angazhimin e vazhdueshëm të rinisë gjilanasë dhe organizatave rinore në përgjithësi që kanë qenë vazhdimisht mbështetëse të institucioneve komunale dhe atyre shëndetësore përmes kampanjave sensibilizuese për qytetarët që të mbrohemi dhe ta kalojmë gjendjen e rëndë të përballjes me pandeminë globale Covid-19. Sikur gjithmonë, Komuna e Gjilanit do të jetë mbështetëse e çështjeve



rinore dhe do t'i trajtojë me prioritetin më të madh nismat dhe programet që kanë target rininë dhe

interesin e përgjithshëm", ka thënë kryetari Haziri. Ndërsa Genc Mustafa, zyrtar për rini, ka theksuar se

kryetarin Haziri e kishin një shtyllë të fuqishme në mënyrë permanente në mbështetje të të rinjve.

# Latifi e Kervani inspektojnë punimet në rrugën e fshatit Zaqisht



RAHOVEC, 14 GUSHT (ER) - Në vazhden e avancimit të bashkëpunimit ndërmjet nivelit qendror dhe lokal, kryetari i Rahovecit, Smajl Latifi, ka pritur të premten në takim ministrin e Zhvillimit Rajonal, Enis Kervan, me të cilin ka biseduar mbi idetë dhe mundësitë për realizimin e projekteve mbi situatën e krijuar nga pandemia Covid-19 si dhe për projektet me periudhë kohore afatgjatë që

mund të realizohen në mes të këtyre institucioneve. "Po ashtu, bashkë vizitua punimet të cilat po zhvillohen në kuadër të projektit: 'Ndërtimi i rrugës në fshatin Zaqisht', i cili është në bashkëfinancim i Komunës së Rahovecit dhe Ministrisë së Zhvillimit Rajonal me vlerë prej 47.813.17 eurosh. Kjo rrugë ul pjerrtësinë e terrenit, ka gjatësi: 360m, gjerësi 6 metra, dy shtresa asfalt, kanali

i kullimit të ujërave atmosferik, gjithashtu, parashihet edhe sinjalizimi horizontal dhe vertikal. E falënderova ministrin Kervan për bashkëpunimin dhe përkrahjen e Komunës së Rahovecit në projekte zhvillimore dhe bashkë u pajtuam që bashkëpunimi i mirëfilltë të vazhdojë edhe në të ardhmen!", ka shkruar Latifi në llogarinë e vet në "Facebook".

# Nis ndërtimi i nënkalimit për vetura në Ferizaj

FERIZAJ, 14 GUSHT (ER) - Në Komunën e Ferizajt ka nisur puna për ndërtimin e njërit prej projekteve më madhore infrastrukturore në zonën qendër siç është ai i ndërtimit të nënkalimit për vetura që bashkon dy arteriet kyçe rrugore, rrugën "Gursel e Bajram Sylejmani" dhe "Liman Rekaj", të "Plus Marketi". Ky projekt realizohet në kuadër të projekcionit infrastrukturor të "Bashkimit të Qytetit". Për ta bërë hapin e parë në këtë vepër infrastrukturore kanë dalë në terren kryetari i Ferizajt, Agim Aliu, bashkë me ministrin e Infrastrukturës, Arban Abrashi, zëvendësministrin e Ekonomisë dhe Ambientit, Muharrem Svarqa, zëvendësministrin e Infrastrukturës, Xhavit Zariqi, drejtues të hekurudhave të Kosovës dhe drejtorë e zyrtarë të tjerë komunalë. Me këtë rast, kryetari Aliu ka thënë se kjo vepër infrastrukturore



paraqet një domosdo investimi duke ditur faktin e lidhjes më të lehtë, më të shpejtë mes dy rrugëve ndër më kryesoret në qytet, për të cilën do të shërbej ky nënkalim. Ndërsa ministri

Abrashi ka thënë se në Ferizaj do të ketë investime të shumta infrastrukturore, duke pasur parasysh edhe zhvillimin ekonomik dhe referencën zhvillimore që ka kjo komunë.


# Komuna e Mitrovicës vazhdon t'i mbulojë shpenzimet e varrimit për qytetarët e saj

MITROVICË, 14 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka pritur të premten në një takim kryetarin e Këshillit të Bashkësisë Islame në Mitrovicë, hoxhë Enis Rama, me të cilin ka nënshkruar memorandum-mirëkuptimi për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për qytetarët e kësaj komune. Në bazë të marrëveshjes së nën-

shkruar, Komuna e Mitrovicës do ta bëjë mbulimin e shpenzimeve të varrimit të kryer nga Këshilli i Bashkësisë Islame në Mitrovicë për rastet e vdekjeve, të cilat shërbime nuk do t'i paguajnë qytetarët, por komuna nga buxheti i vet. Ky memorandum mirëkuptimi është lidhur në afat kohor me kohëzgjatje një vit, me mundësi të vazhdimin.



# “DESTRUKSIONI KREATIV” QË MUNGON NË TREGUN EKONOMIK E POLITIK TË KOSOVËS



Shkruan: Fadil SAHITI

Është interesant se sa shumë ngjashmëri ka demografia e politikës së Kosovës me demografinë e ndërmarrjeve. Kjo e fundit është e stërbushur me entitete afariste shumë të vogla, të cilave u mungon inovacioni dhe eficientia, të cilat as nuk rriten e as nuk vdesin. Ashtu të vogla dhe pa ide inovative, operojnë në treg për një kohë të gjatë, pasi nuk e ndiejnë presionin e ndërmarrjeve të tjera me kapacitete inovative dhe me mendësi të avancuar organizative dhe menaxheriale. Shkurt, tregut të vendeve, si Kosova, u mungon ligji shkatërrues që ekonomisti austriak, Joseph Schumpeter, e quante “destrukcion kreativ”, apo “kreativitet që vret” (creative destruction). Shtetet e

zhvilluara e kanë këtë ligj, që e bën seleksionimin e pamëshirshëm mes ndërmarrjeve inovative dhe produktive, e atyre të ngathëta, të paafta, joeficiente. Këto të fundit janë të detyruara të rinovojnë, ta rrisin eficientën, ose të vdesin e të dalin nga tregu. Ngjashëm me demografinë e ndërmarrjeve, demografia e politikës e Kosovës është e stërbushur me grupime politike të vogla dhe politikanë të paafte të cilët as nuk ndryshojnë, as nuk zhvillohen, por as nuk vdesin politikisht. Kanë mbijetuar për 20 vjet dhe meqë u mungon ana skrupuloze e njeriut, vazhdojnë të mbijetojnë. Kjo ndodh edhe sepse nuk ndihen të rrezikuar nga operimi i ligjit të “destrukcionit kreativ”. Shoqëria e Kosovës ka dështuar të krijojë grupe politike dhe politikanë që do të krijonin standarde në politikë e që, ndoshta, do t'i detyronte politikanët e paafte e jokompetentë, ose të ndryshojnë ose të vdesin politikisht e të dalin nga tregu. Mungesa e këtij ligji ndoshta

është arsyeja kryesore se përse jeta jonë sot është rënduar kaq shumë. Nuk besoj në teori konspirative, të them se e keqja jonë është projektuar nga jashtë, ndonëse nuk e përjashtoj ekzistencën e tyre. Pa asnjë mëdyshje, të keqen e kemi brenda nesh; fajin kryesor e ka kjo kastë politike, por jo vetëm këta. Po cilat janë veçoritë e kësaj demografie politike? Do mundohem të jap pikëpamjen time për këtë. Grupi i parë dhe më karakteristikë është ai i disa ish-luftëtarëve të shndërruar në politikanë, të cilët e kanë kontrolluar jetën politike në Kosovë në këto 20 vjetët e fundit. Veçoria kryesore e këtij grupimi është mungesa e qëllimit, por edhe vizionit për të ndërtuar një shtet funksional, demokratik e me tipare perëndimore. Është interesant se brenda këtij lloji ka pasur shenja të njëllor “mekanizmi shkatërrues”, brenda llojit, por pa përmbajtje kreative. Ajo çfarë ka prodhuar kjo kastë janë politikanët desperado. Ka edhe që janë larguar nga politika, por të tjerët janë kujdesur për

sistemimin e tyre në institucione të larta të shtetit. Disa nga ta sot janë rektorë dhe profesorë universitetesh, drejtorë të institucioneve të ndryshme, e një pjesë e tyre janë shndërruar në manjatë afaristë – natyrisht, manjatë për kushtet e Kosovës. Grupi i dytë i demografisë politike përbëhet nga disa të tjerë që e konsiderojnë veten institucionalistë. Vdesin nga pasioni të identifikohen me ish-themeluesin e partisë së tyre, ndonëse asgjë të përbashkët me të nuk kanë, sepse janë politikanë substancialisht mediokër. Kategori e njerëzve “as-as” – as akademikë as politikanë, as ushtarakë as politikanë. Por, politikën e duan, sepse u sjell edhe pushtet e kapital material. Edhe në këtë parti ka ekzistuar një lloj “mekanizmi shumpeterian”. Edhe këtu destruktiviteti nuk ka qenë i bazuar në vlera e në inovacion. Ka që edhe janë larguar nga politika, por shumica e tyre janë sistemuar në institucionet kryesore të shtetit, borde ndërmarrjesh etj. Madje, disa, pasi kanë kontribuar në destruktivitet politik, janë kthyer

në akademikë, madje në krye të Akademisë. Mozaikun e politikanëve të paafte të Kosovës e përmbushin ‘ngrehalucët’ e opozitës. Të obsesionuar me veten e tyre, me ideologjinë shëlbyese, janë shndërruar në opozitarë të përjetshëm. Sikur nuk dinë gjë tjetër veç kinse opozitarizmit. E patën pushtetin, por literalisht e dorëzuan; e patën mundësinë për ta na zbutur problemet e shumta që kemi, por nuk e bën. Ishte qesharake, por edhe tragjike përpjekja e tyre për ndërtimin e njëmendësisë politike në Kosovë e, besa, edhe jashtë saj. Tragjike sepse për shumëkënd, përfshirë edhe mua, qeveria e udhëhequr nga “ngrehalucët” konsiderohej si “Qeveria e Shpresës”. Si përfundim, duket sikur mediokriteti është pasuria më e madhe që kemi si komb. Mediokrit i gjejmë kudo, në Kuvend, në Qeveri, në ndërmarrje, në Akademi, në universitete, në institucione të kulturës e të sportit, të drejtësisë e të shëndetësisë... Kjo është e dukshme dhe e frikshme, fatqeqsisht.

## NJË RISI NGA POLITIKA E TË RINJVE



Fatbardh KADILLI

Një spot i të rinjve të Forumit Demokrat të Sarandës ishte lajmi më i mirë nga politika në javën që shkoi. Kaloj pa u vënë re, ose nuk u kuptua. Nuk mori as vëmendjen që i takonte nga strukturat komunikuese të PD-së. Meritonte të ishte promovuar nga faqja e PD-së, pse jo edhe e Bashës. Spoti ishte një ftesë e ndjerë: “Ju presim në Sarandë”. Zakonisht, spote të tilla bën ministria apo Agjencia e Turizmit. Por, kësaj here këtë ftesë e bënë të rinjtë e opozitës. Duket si diçka përmbys nga realitetet politike shtampe. Në fakt, është një risi. Këta të rinj, para se të jenë demokratë, janë qytetarë të angazhuar. Para se të jenë opozitarë, janë qytetarë që duan zgjidhje. Nuk ka munguar angazhimi i tyre në opozitë me qeverisjen. Nuk kanë munguar as në protestat e ashpra, nuk kanë abstenuar, madje kanë

mbështetur aksionet radikale të opozitës. Por, ata provuan që janë më shumë se aq. Janë më shumë se refuzim, rezistencë, protestë. Provuam se janë qytetarë dhe performojnë politikë qytetare. Thellësisht e ndryshme nga tradita. Nuk mjafton që opozitat të edukojnë të rinj aktivë dhe militantë të ardhshëm. Opozitat duhet të shërbejnë. Pa u denaturuar në misionin e tyre, opozitat shërbejnë me propozim për politika të ndryshme nga qeveria. Të rinjtë e forumeve kanë shërbyer politikisht duke promovuar ofertën e opozitës për qeverisjen e nesërme. Por këta të rinj sarandjotë shkuan edhe më tej. Shërbyen si të ishin përgjegjës për sot. Turizmi në Sarandë vuan nga bllokimi, vuan nga punimet në sezon të papërshtatshëm, vuan nga tatimorët dhe inspektorët që i mbyten me gjoba, vuan varfërinë, rënien ekonomike, pakësimin e kërkesës së brendshme. Ndaj këtyre vështirësive, ndaj kësaj krize, të rinjtë demokratë sarandjotë kanë bërë më të mirën e tyre. Kanë bërë ftesë që më shumë shqiptarë të zbulojnë bukuritë e qytetit, bukuritë e natyrës,

pasuritë historike, aventurën e turizmit. Ata kanë shërbyer për çdo operator turistik pa dallim. Ndryshe nga nëpunësit e shtetit që bredhin nëpër hotele, restorante si gjobaxhinj, këta të rinj opozitarë ndihmojnë. Ata bëjnë atë që nuk bën shteti. Ndihmojnë të lehtësohet kriza.

Kjo është sjellje ndryshe në politikë. Shpesh, politika fërkon duart dhe bën llogari cinike për krizat. Por, nga krizat askush nuk fiton. Kriza i varfëron të gjithë. Politika që gjallon mbi krizën nuk shpërblehet nga besimi dhe vota. Politika që propozon, politika që shërben,

shpërblehet me besim dhe me votë. Kjo është risia e Forumit Rinor Demokrat të Sarandës. Këtë duhet ta shohim të gjithë si një shembull që ndoshta nuk do ta ndryshojë modelin e të berit politikë, por, më e pakta, do ta pasurojë atë. (Marrë nga *Panorama*)



## Eksperti amerikan: Vaksina kundër Covid-19, në nëntor ose dhjetor

WASHINGTON, 14 GUSHT - Mjeku Francis Collins, drejtor i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë, ka thënë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk duhet të presin që të shohin një vaksinë të aprovuar deri në muajin tetor. E gjithë kjo si referencë për spekulimet se presidenti Donald Trump mund të nxirrte para kohe një vaksinë kundër Covid-19 përpara ditës së zgjedhjeve, raporton "CNN". "E vetmja mënyrë që mund ta imagjinoja është nëse, në të

vërtetë, një nga fazat e testeve që tani është duke u regjistruar me shpejtësi absolute rekorde, do të jetë 100 për qind efektive. Dua të them, ky është një lloj numri i shumë të pamundurave të grumbulluara mbi njëra-tjetrën. Pra, përsëri unë nuk do të pres që të shohim, mbi bazën e asaj që dimë në mënyrë shkencore, se do ta kemi në muajin tetor. Ndoshta nëntor, dhjetor do të ishte basti më i mirë", ka thënë ai. Collins, i cili është bashkuar

me thirrjen nga Paul Mango, zëvendëseshë i stafit të Departamentit të Shëndetit dhe Shërbimeve Njerëzore të ShBA-së, ka thënë se operacioni "Warp Speed" është ende në rrugën e duhur për të ofruar 300 milionë doza të një Covid-19 të sigurt gjersa vaksina efektive do të dalë në treg në janar të vitit 2021. Ndryshe, 20.6 milionë njerëz në botë janë infektuar me koronavirus gjersa kanë ndërruar jetë mbi 749 mijë persona.



## BE-ja shqyrton sanksione ndaj Bjellorusisë pas akuzave për "torturë"



BRUKSEL, 14 GUSHT - Bashkimi Evropian synon ta rrisë presionin ndaj presidentit të Bjellorusisë, Alyksandr Lukashenka, si përgjigje ndaj shtypjes brutale të protestave të shkaktuara nga zgjedhjet, të cilat blloku evropian i ka përshkruar si "as të lira, as të drejta". Pak para mbajtjes së takimit të jashtëzakonshëm të ministrave të Jashtëm të BE-së në Bruksel, autoritetet bjelloruse kanë nisur lirimet e qindra të ndaluarve në mëngjesin e së premtes. Shumë prej të burgosurve kanë folur për kushtet e tmerrshme të ndalimit, për rrahje dhe keqtrajtime të tjera, derisa organizata ndërkombëtare për të drejta të njeriut, "Amnesty

International", ka thënë se këto pretendime tregojnë për "torturë të përhapur". Të paktën dy protestues kanë vdekur dhe rreth 6 700 persona janë ndaluar prej kur kanë shpërthyer protestat më 9 gusht, meqë rezultatet zgjedhore kanë treguar se lideri autoritar, Lukashenka, ka fituar një mandat të gjashtë presidencial me 80 për qind të votave. Ky pretendim është kundërshtuar nga kandidatja opozitare Svyatlana Tsikhanouskaya, e cila është detyruar të ikë në Lituani. Shefi i BE-së për politikë të jashtme, Josep Borrell, që ka bërë thirrje për organizim të takimit të diplomatëve të lartë të bllokut evropian, ka kërkuar

edhe dhënie fund shtypjes në Bjellorusi si dhe respektim të të drejtave të njeriut dhe demokracisë. Ai ka thënë se një ndryshim i madh politik është parakusht për zhvillim të mëtutjeshëm të marrëdhënieve në mes të BE-së dhe Bjellorusisë. Në Berlin, ministri i Jashtëm gjerman, Heiko Maas, ka thënë se BE-ja "duhet ta rrisë presionin ndaj udhëheqësit" në Minsk. "Është krejtësisht e qartë se shtypja brutale dhe ndalimi i protestave paqësore nuk do të tolerohen në Evropën e shekullit 21", ka thënë Maas. Ai ka thënë se në BE ka "diskutime intensive për sanksione" kundër regjimit bjelloruse.

## Qeveria afgane nis fazën e fundit të lirit të të burgosurve talibanë

Kabul, 14 gusht - Qeveria afgane ka thënë më 14 gusht se ka nisur lirimet e 400 militantëve talibanë, në kuadër të fazës së fundit të këmbimit të të burgosurve që synon ta hapë rrugën për bisedime të paqes mes Kabulit dhe talibanëve. Një grup prej 80 të burgosurve talibanë janë liruar nga burgjet më 13 gusht, ka thënë Këshilli Kombëtar për Siguri në Afganistan. Presidenti i këtij shteti, Ashraf Ghani, ka njoftuar më 9 gusht rreth synimit të tij për të liruar 400 militantë talibanë, shumica e të cilëve janë dënuar për sulmet e përgjakshme ndaj afganëve dhe të huajve. Lirimi i të burgosurve përbën përpjekjen e fundit për nisje të bisedimeve për paqe në mes të qeverisë së përkrahur ndërkombëtarisht në Kabul

dhe talibanëve, ashtu siç është paraparë në një marrëveshje të nënshkruar në muajin shkurt në mes të militantëve dhe Shteteve të Bashkuara. Të dyja palët kanë thënë se pak ditë pasi të përfundojë ky proces i këmbimit të të burgosurve, ata do të jenë gati për nisje të bisedimeve të brendshme, në Doha të Katarit. Talibanët në anën tjetër nuk janë deklaruar ende për lirimet. Kabuli deri më tani ka liruar 4 600 talibanë nga 5 000, por ishte zotuar fillimisht në marrëveshje. Zyrtarët afganë i kanë përshkruar të burgosurit e mbetur si njerëz shumë të rrezikshëm, duke i akuzuar për organizim të sulmeve në ambasada, në sheshe publike dhe zyra qeveritare, duke lënë të vdekur mijëra civilë në vjetët e fundit. Talibanët është thënë se deri më tani kanë



liruar 1 000 të burgosur qeveritarë. Përveç tërheqjes së trupave amerikane dhe të atyre të koalicionit, në

marrëveshjen në mes të ShBA-së dhe talibanëve, u është bërë thirrje këtyre të fundit që të garantojnë se Afganistani nuk

do të përdoret si tokë për organizim të sulmeve terroriste ndaj ShBA-së apo aleatëve të saj.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





# Zogu, serbët dhe vrasja e Hasan Prishtinës

Nga: Dorian KOÇI

Më datën 13 gusht 1933, agjencitë telegrafike të Ballkanit përcollën lajmin se në Selanik ishte qëlluar për vdekje ish-kryeministri i Shqipërisë dhe politikani Hasan Prishtina. Lajmi, ashtu si pritej, shkaktoi pështjellim në gjithë kancelaritë e Ballkanit, por reagimi më i madh natyrisht ishte nga opinioni publik shqiptar këndeje e andej kufirit. Vrasja e patriotit Hasan bej Prishtinës në Selanik të Greqisë, nga një emigrant pothuajse i panjohur, Ibrahim Çelo, jo vetëm që tronditi gjithë opinionin mbarëshqiptar, por dhe hodhi hije të forta dyshimi mbi autorësinë e vërtetë apo urdhëruesin e kësaj vrasjeje, vetë Naltëmadhëninë e tij, Ahmet Zogu. Ky dyshim vinte jo sepse autori Ibrahim Çelo deklaroi një gjë të tillë në organet e policisë greke, por sepse mënyra dhe ekzekutimi i vrasjes ishte pothuajse i njëjtë si vrasja e Luigj Gurakuqit. Atentatori, ashtu si dhe në rastin e Gurakuqit, ishte një i njohur i vjetër i viktimës dhe të dy martirët e lirisë shqiptare kanë rënë viktimë të pabesisë së vrasësve.

Gazeta greke "Të reja nga Maqedonia" përshkruan momentet e vrasjes së patriotit

Hasan Prishtina si më poshtë: Vrasja u krye në orën 2:00 mbas dite më datë 13 gusht 1933. Në rrugën Çimisqi u pa një zotëri i moshuar, i mbajtur mirë dhe me tipare simpatike, të ecte përkrah e të fjaloste me një person të veshur mirë, i gjallë, sa e tradhtonte dhe toni i zërit. Arritën në kryqëzimin e rrugës Çimisqi-Vogaxhiku dhe po drejtoheshin për tek bakallhane "IVI" dhe në largësi dy hapa nga kinkaleria e invalidit J. Janopullo. Njeriu me pamje të zymtë nxori rrufeshëm revolverin e markës "Smith" dhe shtiu kundrejt bashkëbiseduesit, i cili ishte Hasan bej Prishtina, që ra në trotuar. Kalimtarët e mbledhur nga të dy të shtënat, panë vrasësin të turret me mizori të parrëfyer mbi viktimën dhe t'i zbrazë edhe tre plumba të tjerë, dy në kraharor dhe të tretën në kokë, si e shtënë vdekjeprurëse, për të qenë i sigurt për përfundimin e aktit të vrasjes.

Siç kuptohet dhe nga përshkrimi i gazetës, ajo duket që ishte një vrasje e porositur, pasi vrasësi në mënyrë makabre nuk ndalet as kur viktimë ishte i rënë përdhe, por e qëllon për t'u siguruar në kokë. Mirëpo, ajo që i përforcon më shumë bindjet se Hasan Prishtina ka rënë viktimë e ambicieve të Mbretit Zog për të përforcuar pozitat e tij sunduese

janë rrethanat ndërkombëtare dhe koha kur u realizua vrasja.

Hasan Prishtina, një nga krijuesit e Pavarësisë së Shqipërisë, udhëheqësit të kryengritjes së viseve shqiptare në vitin 1913 kundër pushtimit të tyre nga ushtria serbe, restauruesit të pavarësisë shqiptare më 1920 dhe kryeministrit të një qeverie shqiptare në 1922, ishte një nga përkrahësit më të flaktë të përfshirjes së Shqipërisë në problemin kosovar dhe realizimit të një politike më aktive të Shqipërisë për të realizuar bashkimin kombëtar. Mirëpo, këto dëshira dhe plane të tij binin ndesh me dëshirat dhe synimet e një grupi më të vogël deputetësh dhe politikanësh, që kryesisht vinin nga radha e ish-nëpunësve të Perandorisë Otomane, ku ndjenja nacionale nuk kish zënë vend njëlloj si te grupi i nacionalistëve ku Prishtina ishte një nga themeluesit e kësaj rryme, që në vitin 1910. Mes këtij grupi politikanësh me vizion të ngushtë kombëtar dhe të interesuar vetëm për të përforcuar pushtetin e vet lokal që e shikonin të ushtruar vetëm brenda kufijve të Shqipërisë, shquante Ahmet bej Zogolli, përfaqësuesi i një familje lokale fisnike shqiptare, që nuk kish shkëlqyer shumë në karrierën perandorake si familjet

e tjera të mëdha shqiptare, si: Vlorajt, Vrionasit, Bushatllinjët, Libohovajt etj.

Ahmet Zogolli, i zgjedhur për herë të parë kryeministër në vitin 1922, do të deklaronte nga tribuna e Parlamentit shqiptar se "shteti shqiptar është i vogël dhe politika jonë duhet të jetë e qartë, e sinqertë dhe pa iluzione të cilat mund të na dëmtojnë shumë" (me fjalën iluzione nënkupto përkrahjen e kauzës për t'u bashkuar me Shqipërinë të territoreve shqiptare të mbetura jashtë kufijve).

Problemi i përkrahjes së popullive shqiptare të lëna jashtë kufijve apo lënies së tyre në fatin e vet ishte një problem që ndante shumë politikanë kosovarë aktivë në jetën politike të Shqipërisë, si Hasan Prishtina, Bajram Curri, Kadri Hoxha etj., nga pjesë e politikanëve shqiptarë që dëshironin të konsolidonin në radhë të parë pushtetin e tyre në Shqipëri, qoftë dhe përmes aleancave me fqinjët. Kjo mospërputhje e madhe për idenë kombëtare dhe mënyrën e ndërtimit të kufijve të shtetit shqiptar, i kish detyruar që më herët, në vitin 1918, politikanët kosovarë të themelonin "Komitetin për Mbrojtjen e Kosovës". Në komitet, përveçse politikanëve kosovarë merrnin

pjesë dhe shumë patriotë të tjerë shqiptarë, kryesisht politikanë të opozitës shqiptare, që si përfaqësues të shtresës së mesme dhe intelektuale kishin një vizion më të qartë të idesë kombëtare. Një pjesë e madhe e tyre u larguan jashtë atdheut pas rikthimit të Zogut më dhjetor 1924 dhe përbënë për një kohë të gjatë emigracionin aktiv antizogist dhe alternativën tjetër qeverisëse në rast të ndërrimit të pushtetit në Shqipëri.

Të organizuar në organizata të ndryshme politike sipas bindjeve të tyre, ata nuk përbënin ndonjë rrezik të madh për Zogun, por në momentet kur për shkak të konjunkturave politike në Ballkan ata fitonin përkrahjen e ndonjë fuqie të madhe, ktheheshin në një rrezik potencial për regjimin zogist. Kjo ishte dhe një nga arsyet që Zogu, herë pas here, mendohej të godiste politikisht cilindo nga këto grupe emigracioni, për të siguruar pozitat e veta në Shqipëri, por dhe për të dhënë mesazhin e duhur Italisë, si të vetmes fuqi të madhe që i ishte dhënë përparësi në Shqipëri se ai ishte i vetmi partner që duhej të merrej në konsideratë.

Mirëpo, gjërat filluan të ndryshojnë aty rreth viteve 1931-1932, kur u kuptua se shteti

shqiptar nuk kishte aftësitë e duhura financiare për të paguar kreditë e marra nga italianët, që me nënshkrimin e paktit të vitit 1926. Në këto kushte, italianët filluan të bënin presion ndaj Zogut, duke i avancuar kërkesat rreth prezencës së tyre në Shqipëri. Kështu, në këmbim të shtyrjes së kthimit të interesave të kredisë, ata kërkuan që në krye të xhandarmërisë shqiptare të vendoseshin oficerë italianë, dhe t'i jepesh mbretërisë italiane monopoli i sheqerit, telegrafit dhe elektrikut. Si mund të kuptohet lehtë nga këto kërkesa, politika italiane kërkonte që të vinte nën një diktat akoma më të rëndë Mbretërinë shqiptare dhe të shtronte rrugën për pushtimin e mëvonshëm të Shqipërisë. Këto kërkesa që çonin në pakësimin e sovranitetit të Shqipërisë, natyrshëm e shtynë Mbretin Zog që t'iu kundërvihet dhe të përpiqej të hartonte një politikë të re të jashtme.

Vitet 1931-1935, sipas prof. Paskal Milos, janë vitet kur Zogu përpiqet të luajë një politikë të pavarur të jashtme dhe për këtë gjë tenton afrimin politik dhe me fuqi të tjera të mëdha dhe me shtetet e tjera në Ballkan. Si zakonisht, në raste të tilla kthesash politike, trokitet te miqtë e vjetër që në rastin e Zogut, ishte Mbretëria Serbo-Kroate-Slllovene. Në këto kohë po bëheshin përgatitje për Paktin Ballkanik dhe Zogu dëshironte t'i bashkëngjitej kësaj iniciative. Në themel të këtij pakti ishte rregullimi i marrëdhënieve diplomatike dhe shuarja e kontradiktave për kufijtë midis shteteve ballkanike, gjë që në fakt shkonte në kundërshtim me politikën italiane që dëshironte të mbante ndezur vatra konflikti, për ta pasur më të lehtë ndërhyrjen në Ballkan. Për këtë arsye ata sponsorizonin dhe përkrahnin çdo lëvizje që nga ta konsiderohej si irredentiste, por



në thelb ishin lëvizje-protesta ndaj padrejtësive që u ishin bërë popullsisë në Ballkan, për të krijuar Serbinë e Madhe, Greqinë e Madhe dhe Bullgarinë e Madhe. Mes këtyre lëvizjeve, që nga viti 1925, të patriotëve kroatë, slovenë dhe maqedonas, të gjithë përfaqësues të popullsisë që vuanin nga shovinizmi serb, diplomacia italiane ishte në kontakt dhe me eksponentë të Komitetit për Mbrojtjen e Kosovës dhe Hasan Prishtinën, si një nga udhëheqësit e këtij komiteti. Hasan Prishtina kishte zgjedhur për të jetuar në Selanik, si një qytet ku ai kish mbaruar studimet e shkollës së mesme, por dhe sepse ishte afër Shqipërisë dhe Kosovës nga ku mund të vazhdonte të influenconte në jetën politike të vendit. Duke qenë se ai vinte nga një familje e pasur, kishte blerë një shtëpi në një nga lagjet e pasura të Selanikut dhe një

pjesë të pasurisë së tij e përdorte për të sponsorizuar të rinj kosovarë që dëshironin të shkolloheshin. Në fakt, në momentet e vrasjes së tij, ish-kryeministri i Shqipërisë nuk paraqiste ndonjë rrezik të madh për Zogun që e kish konsoliduar pushtetin e tij tashmë në Tiranë, por si mbështetës i idesë për një bashkim të Kosovës me Shqipërinë përbënte rrezik për Mbretërinë jugosllave. Në këto vite, në bisedimet që Zogu filloi me jugosllavët për të fituar mbështetje diplomatike ndaj Italisë, u fol dhe për një kredi jugosllave që do t'i lëvrohej për të mos qenë më i varur financiarisht nga italianët.

Zogu, si një feudal tipik intrigant, edhe pse e dinte se lëvizja e vitit 1932 kundër tij kish qenë e organizuar nga legata jugosllave në Vlorë, nuk e kishte për gjë të hynte në marrëdhënie me ta, me kusht që t'i shtynte ditët e mbretërimit të tij, që nga lakmia që kish pasur për para dhe pushtet e kish dënuar me vdekje me paktet e Tiranës, të nënshkruar me italianët në mesin e viteve 1920. Koha dhe mënyra sesi u procedua të shtyn të mendosh se vrasja dhe eliminimi fizik i patriotit Hasan Prishtina i datës 13 gusht 1933 ka qenë një pjesë e marrëveshjes dhe besnikërisë që Zogu po u tregonte jugosllavëve për ta pasur dhe më të lehtë aderimin në Paktin Ballkanik.

Pakti Ballkanik po ndërtohej me



insistimin diplomatik të Francës, e cila kishte si shtet të përkëdhelur të saj në Ballkan, mbretërinë jugosllave dhe Zogu e kuptonte se për të fituar simpatinë e fuqive të tjera evropiane, rrua i kalonte nga Beogradi. Si një bashkëpunëtor i vjetër i tyre, Zogu i njihte mirë dëshirat dhe kushtet e afimit me ta, ndaj dhe zgjizmi si rrymë mendimi që mbizotëroi në Shqipëri, pavarësisht një shashke propagandistike të vitit 1928, kur Zogu u shpall mbret i shqiptarëve dhe ky përcaktim solli një notë proteste nga ana e Beogradit, në përgjithësi insistoi që kombi shqiptar shtrihej vetëm brenda mbretërisë shqiptare dhe nuk shkaktoi ndonjë rrezik diplomatik për mbretërinë jugosllave.

Kështu ish-kryeministri i Shqipërisë dhe burri i shtetit shqiptar, Hasan Prishtina, u zgjodh për t'u bërë kurban i një kombinacioni politik të dështuar që në fillim, pasi loja që dëshironte të luante Zogu nuk mund të kishte sukses, pas nënshtrimit total prej gati 8 vjetësh që ai kish bërë ndaj Italisë fashiste. Për më tepër, ky kombinacion politik nuk u shkonte për shtat shqiptarëve në atë kohë, pasi çimentonte ndryshimet territoriale që ishin bërë me pa të drejtë mbi kurzinin e popullsisë shqiptare në rajon dhe e varroste për së gjalli ëndrrën e bashkimit të tyre kombëtar.

Qëllimet e vërteta të vrasjes së Hasan Prishtinës kuptohen tërthorazi dhe nga deponimet e

vrasësit Ibrahim Çelo në policinë greke, ku sipas gazetës "Të reja nga Maqedonia", ai deklaroi se akti i tij u dedikohet motiveve politike. Ndërkaq pretendoi se ish-kryeministri i atdheut të tij ishte komit dhe bashkëpunonte me komitetin bullgaromaqedonas me qëllim që të vrisnin mbretin e Shqipërisë, Ahmet Zogun. Planet, thotë atetatori, m'i tregoi Hasan Prishtina përpara pesëmbëdhjetë ditëve, kur po vinim prej Vjene (Austri) dhe më bënte presion që të bëhesha unë kryetar i bandës komite dhe të shkoja në Tiranë ku të vrisja mbretin Ahmet Zogun. Prishtina, vijon vrasësi, më premti shpërblim mujor dhe një shpërblim dhuratë mbas aktit të vrasjes, por unë i kundërshtova këto propozime të tij, sepse jam pro regjimit të mbretit Ahmet Zogu dhe nuk dëshiroja të bëhem vegël e Hasan Prishtinës, të cilin në Shqipëri e quajmë tradhtar.

Pra, si mund të kuptohet lehtë, Hasan Prishtina prishte gjumin e Monarkisë jugosllave, prandaj u përzgjedh për t'u vlarë në afrimin politik të radhës të Zogut me serbët, por si zakonisht për t'i dhënë më tepër besueshmëri aktit u deklarua se ai planifikonte dhe vrasjen e mbretit Zog, nëpërmjet një tregtari frutash që banonte në Nicë të Francës! Ironi më të madhe nuk mund të kishte dhe regjimi zogist, sado që mundohet të justifikojë se s'kishte gisht në këtë punë, për gjithë opinionin publik ishte e qartë se po shënonte vrasjen politike të radhës.



## FemArt Festival vjen me edicionin e tetë për këtë vit, publikohen datat

Festivali FemArt, tashmë i njohur edhe ndërkombëtarisht, një festival ky me karakter feminist, ka lajmëruar se do të zhvillojë edicionin e tetë i cili do të mbahet në datat 15 deri me 20 tetor të këtij viti, shkruan KultPlus. FemArti është festival i cili ka arritur që përmes artit të mirë dhe kualitativ të krijuar nga artistet dhe aktivistet të



fuqizojë gratë dhe vajzat në njohjen e të drejtave të tyre të plota me qëllim të arritjes

së barazisë politike, ekonomike, kulturore, personale, dhe shoqërore.

**Moto e festivalit FemArt 2020 është "Solidariteti dhe Qëndrueshmëria".**

Solidariteti si parim i mbështetjes së ndërsjellë në mes grave dhe vajzave, artisteve dhe aktivisteve që

punojnë për barazinë gjinore dhe të drejtat e grave. Qëndrueshmëria si aftësi për t'i bërë ballë fatkeqësive, traumave dhe sfidave duke u ngritë në këmbë sa herë rrëzohemi e duke e ngritë zërin sa herë që mundohen të na heshtin.

Koncepti dhe formati i festivalit FemArt këtë edicion ka ndryshuar si rezultat i pë-

balljes me COVID-19. Në solidaritet dhe përkrahje FemArt do të sjellë krijime artistike origjinale nga artistet dhe aktivistet e vendit. Përgjatë shtatë edicioneve të kaluara FemArt Festival ka sjellur më shumë se 240 aktivitetet artistike dhe kulturore si dhe ka mbledhur rreth 25,000 persona në audiencë.

**E rrallë**

# Kujtimet e këqija do të mund të fshihen

Është zbuluar një mekanizëm që do të mund ta ndryshojë kujtesën, atë që përkon me një përvojë negative. Studimi mban firmën e Universitetit të Bolonjës dhe duke qenë se ka të bëjë me një manipulim, është ngritur edhe një komitet etik për vëzhgim të rreptë. Eksperimentimi ka zgjatur dy vjet mbi një kampion të përbërë nga 84 vullnetarë, mbi të cilët me anë të simulimeve cerebrale është arritur t'i shkëputet frika nga kujtimi që ia ka provokuar. Sipas autorëve të studimit, kujtimet, që në momentin që lindin, janë të dobët e brishtë, pra të modifikueshëm. Është një dritare e vogël që ndan



pikërisht krijimin dhe forcimin e kujtimit dhe pikërisht këtu është pika e dobët ku shkencëtarët kanë ndërhyrë. Zona ku ndodh kjo gjë është zonën e prefrontale. Ky zbulim, pavarësisht se është i lidhur

ngushtë me manipulimin, mendohet që nëse zhvillohet më tej, të përdoret pikërisht për të ndërhyrë mbi fobitë, apo streset posttraumatike, por edhe për trajtimin ndaj varësive nga substancat narkotike.

## BARSOLETA E DITËS



**Mësuesi:** Në cilin trup qiellor ke dëshirë të shkosh?  
**Biondina:** Në diell.  
**Mësuesi:** Nuk e dini se sapo të afroheni atje digjeni dhe shkriheni nga nxehtësia?  
**Biondina:** Pse budallaqë jam unë, sigurisht që atje do të shkoj natën!



## Në Kino ABC nuk ka shfaqje



E jashtëzakonshme

# Ky është burri që nuk është larë për 60 vjet

**A**i është beqar dhe është në kërkim të dashurisë. Për ta fituar zemrën e tij, ju do të duhet ta pranoni stilin e jetës së tij jokonvencionale. Amou Haji nuk është larë për 60 vjet, sepse ai beson se të qenit i pastër do ta bëjë atë të sëmurë dhe ushqimi i tij i preferuar është derri i kalbur. Haji, 80-vjeçar, thotë se ai zgjodhi këtë mënyrë të jetës pasi kaloi disa pengesa emocionale në rin-

inë e tij dhe që prej asaj kohe mbase në mënyrë befasuese ai është bërë pak i izoluar. Shtëpia e tij është në fshatin Dejgah në provincën jugore të Farsit në Iran, ku dikur, një grup të rinjsh i ofruan që të bënte dush por, për fat, ai arriti të shpëtonte. Natën ai ose fle në një vrimë në tokë, që është krejtësisht si një varr, ose në një kasolle të hapur me tulla, e cila shqetësonte vend- asit të ndërtuar për të.

## FOTO E DITES



Disa persona shihen duke dërguar lule në vendin ku ka vdekur një person përgjatë protestave kundër qeverisë në Bjellorusi. /Rel/

 <p><b>DASHI</b> Mes shoqërisë suaj do të keni një humor të mirë dhe do të arrini të bëni ato gjëra që keni dashur gjithmonë. Fryma e lirë që ju karakterizon, do t'ju bëjë më konstruktiv.</p>	 <p><b>DEMI</b> Do të kujdeseni për çdo para që fusni apo nxirrni nga xhepi. Nëse hiqni dorë nga gjërat e zakonshme, ju do të merrni perspektiva më të mëdha.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Ju keni një qiell të hapur për perspektivat e shkëlqyera. Aventurat momentale dhe kënaqësitë për ata që kanë vendosur t'i kalojnë pushimet me njerëz që i njohin.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Njerëzit ju besojnë dhe ndihen të qetë në praninë tuaj. Ju e dini se si t'i vendosni të tjerët në lehtësi pa asnjë përpjekje.</p>	 <p><b>LUANI</b> Suksese të mëdha për ata që punojnë në botën e mediave, komunikimit, studimeve, tregtisë dhe bashkëpunimeve me njerëz të huaj. Përgjigjja që prisnit po vjen.</p>	 <p><b>VIRGJËRËSHA</b> Një shqetësim delikat dhe disa dyshime mund ta prishin ditën tuaj sot, por nuk keni arsye pse të shqetësoheni.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Sfera sentimentale shkëlqen, pavarësisht gjendjes suaj. Yjet ju sugjerojnë që të ecni para dhe të bëni disa ndryshime në jetën tuaj.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Në këtë verë të bukur ju jeni ndërgjegjësuar që të mos u dorëzoheni polemikave dhe ndërhyrjeve që mund të përballeni dhe në fund të merrni gjithmonë kënaqësinë e merituar.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Sfera sentimentale ka mbrojtje të mira astrale që stimulojnë kënaqësitë e jetës, dashurinë në veçanti.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Tani më shumë se kurrë është e mençur t'i përmbaheni një regjimi shëndetësor të rregullt. Për ta përmirësuar stilin e jetës suaj, është e nevojshme të mos devijoni nga orari i zakonshëm.</p>	 <p><b>UJORI</b> Kjo e premtë është ndriçuar nga yje që flasin për dashuri, kënaqësi për t'i ndarë me ata që i doni, për krijimtari dhe artin.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Kontrastet e vogla planetare përpiqen të vënë në dyshim hijeshinë dhe kreativitetin tuaj. Do të kapërceni çdo pengesë me ndihmën e mençurisë së dhënë nga Saturni.</p>




## Miley Cyrus zbulon se përvoja e saj e parë seksuale ishte treshe



**M**iley Cyrus ka zbuluar se përvoja e saj e parë seksuale ishte një treshe me dy vajza. Këngëtarja, 27 vjeçe, e cila vetëm pak ditë më parë ka publikuar këngën e saj "Midnight Sky", ka treguar disa nga përvojat e saj në jetën private. Ajo ka thënë se burri i parë me të cilin ka fjetur ndonjëherë ishte Liam Hemsworth. Çifti më

vonë ka vazhduar në martesë, por u ndanë shpejt fatkeqësisht. Këngëtarja ka thënë se hera e parë që është bërë bashkë me dikë, ishin dy shoqe të saj dhe për këtë ka gënjyer edhe ish-bashkëshortin. Miley ka thënë se arsyeja se si shoqet e saj i përshkruanin lidhjet me meshkuj ka shtyrë atë të fillojë lidhje me vajza.



## Dua Lipa, magjepsëse në fotesionin e ri

Dua Lipa ka kaluar karantinën në shtëpinë e vet në Britani së bashku me Anwar Hadid. Ajo duket më e bujshme se kurrë, ndërsa ka ndarë një seri imazhesh mahnitëse teksa ka informuar fansat se është rikthyer në punë, shkruan "Daily Mail".

Këngëtarja, 24 vjeçe, ka treguar sensin e stilit në fotografi, ku shfaqet me një bluzë ngjyrë vjollcë me mëngë të shkurtra e dekolte të zbukuruara me pendël. Krahas fotografive, këngëtarja ka shkruar në mbishkrimin e tyre në "Instagram": "Kthim në punë".

## 22-vjeçarja "çmend" fansat



**Y**lli i "Love Islands" në Britani, Georgia Steel, i ka lënë pak vend imagjinatës me foton e postuar në rrjetet sociale. Në fakt, 22-vjeçarja nuk ka pasur asnjëherë problem t'i tregojë format trupore. Megjithatë, me foton e fundit veçse ka rritur

temperaturat. Ajo është shfaqur topless dhe vetëm me një këmishë sipër. Provokuese, por ka mjaftuar për t'i bërë fansat të vërshojnë me komente pozitive. "Sheqer me kafën tënde, shpirt?", ka shkruar ajo në llogarinë e vet në "Instagram".

## Aktorja Munn: Ish i dashuri nuk dinte të kryente marrëdhënie seksuale



**A**ktorja amerikane Olivia Munn ka ndarë një sekret me publikun. Ajo është shprehur se një prej të dashurve të saj në të shkuarën ishte "shumë keq në marrëdhënie seksuale". Deklaratat e saj vijnë pas ndarjes me Aaron Rodgers dhe Tucker Roberts. Aktorja ka folur për komedianen Whitney Cummings rreth

përvojave të saj në të shkuarën dhe se ish i dashuri nuk i plotësonte nevojat. "Kisha një të dashur, i cili ishte më i keqi, më i keqi në seks", ka thënë ajo. Munn ka zbuluar se ky person i veçantë dëshironte të kryente marrëdhënie me drita fikur që, sipas saj, do të thotë që nuk donte t'i shikonte fytyrën sepse përballë kishte një vajzë.

EURO GLASS  
SAINT-GOBAIN SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'  
TEL: 045/82 82 82

## Topalli, pas transferimit në Turqi: Është dashur shumë sakrificë për të arritur deri këtu

Jetmir Topalli, pasi nënshkroi kontratë trevjeçare me skuadrën e Yeni Malatyaspor, ka thënë se është dashur shumë mund e sakrificë për të arritur deri në këtë nivel. “Për të arritur deri këtu më është dashur shumë punë dhe sakrificë, përkushtim dhe përkrahje, të cilët janë të domosdoshme për sukses, sidomos nga njerëzit që i do dhe të duan. Pa dashur ta harroj askënd, dua t’i falënderoj të gjithë ata që kontribuuan për formimin tim profesional”, ka thënë Topalli



**Dekani Musa Selimi:  
Studenti Jetmir  
Topalli, shembull për  
t’u ndjekur**

Dekani i Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, Musa Selimi, nëpërmjet një postimi në profilin e vet në “Facebook” e ka përshëndetur transferimin e futbollistit Jetmir Topalli në skuadrën e Yeni Malatyaspor. Selimi ka thënë se studenti Topalli është shembull për t’u ndjekur nga gjeneratat e ardhshme. “Studenti ynë Jetmir Topalli, një yll që po shndritë në fushën e futbollit, ai sot nënshkroi kontratë profesionale me ekipin turk Malatyaspor. Jetmiri shkante në bibliotekë për të lexuar dhe përgatitur provimet ku edhe u vlerësua me nota shumë të larta. Ai është djali i sinqertë e shembull se si me punë arrihet shumë në profesion. Në emër të Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit të Universitetit të Prishtinës ‘Hasan Prishtina’ i urojmë shëndet e shumë suksese në karrierë, duke qenë krenarë me edukimin dhe arritjet e tij”, ka shkruar Selimi.

**EPOKA E RE** **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 14 GUSHT - Futbollistit Jetmir Topalli ka bërë hapin më të madh dhe më të rëndësishëm në karrierën futbollistike, pasi të enjten e ka zyrtarizuar kalimin nga Ballkani në skuadrën e njohur turke Yeni Malatyaspor. Një ditë pas kalimit në klubin turk, Topalli nëpërmjet një letre të gjatë u është drejtuar të gjithë atyre që ndihmuan në zhvillimin e tij si futbollist. “Siç edhe jeni informuar në media, karriera ime personale ka marrë një kahe tjetër të jashtëzakonshme për mua, duke arritur kontratë profesionale për tre vjetet e ardhshme me skuadrën time të re të Superligës turke, Yeni Malatyaspor. “Për të arritur deri

këtu më është dashur shumë punë e sakrificë, përkushtim dhe përkrahje, të cilët janë të domosdoshme për sukses, sidomos nga njerëzit që i do dhe të duan. Pa dashur ta harroj askënd, dua t’i falënderoj të gjithë ata që kontribuuan për formimin tim profesional”, ka thënë Topalli. “Falënderoj Zotin e madhërisëm që për këto vite më dha shëndetin, më ruajti nga lëndimet dhe ma lehtësoi rrugën që të jem ky që jam tani. Falënderim i veçantë për familjen time që gjithmonë ishte krahu im i djathtë. Faleminderit qytetit të Kaçanikut, shkollës ‘New Star’, ku i fillova hapat e parë të futbollit! Faleminderit shkollës së futbollit ‘Besëlidhja’ që më formoi dhe përkrahi gjithmonë! Faleminderit skuadrës së 2

Korrikut dhe Vushtrrisë! Faleminderit Ballkanit tim që do ta kem në zemër derisa të marrë frymë, skuadër që tashmë ka zënë vend të pashlyshëm në zemrën time së bashku me tifozët fantastikë ‘Xhebsat’! Faleminderit shokë dhe bashkëlojtarë! Faleminderit Fakultetit të Kulturës Fizike, të gjithë profesorëve që më përgatitën dhe afirmuan në aspektin intelektual. Gjatë këtyre viteve kam kaluar e punuar me disa trajnerë që më kanë përgatitur që të jem ky që jam. Faleminderit të gjithëve për punën dhe mundin që keni bërë për mua! U jam mirënjohës gjithë jetën presidentit të Ballkanit, Arsim Kabashi dhe trajnerit Ismet Munishi, që besuan në mua dhe ishin jashtëzakonisht korrektë në çdo

sekondë ndaj meje dhe më lejuan të kaloj në kampionatin turk, edhe pse kisha edhe një vit marrëveshje me klubin. Falënderim i veçantë shkon për drejtorin e shkollës ‘Besëlidhja’, Driton Bajrami, drejtuesit dhe trajnerët e shkollës, që ishin krahu im i fortë deri tani dhe më drejtuan e më mundësuan të arrij deri këtu. Gjithashtu, falënderoj menaxherin tim Rrahman Kice që bëri të pamundurën me kompaninë ‘Kia-Sportmanagement’ që të depërtoj në futbollin evropian dhe të kem një kontratë profesionale e të favorshme për mua”, ka përfunduar letra e Topallit. Sulmuesi i talentuar ka marrë shumë urime për transferimin e tij nga ish-klubet e tij, por edhe nga opinionin sportdashës.

## MKRS-ja nënshkruan memorandum për Qendrën e Sportit në Zubin Potok

PRISHTINË, 14 GUSHT - Në kuadër të mbështetjes së komunave të Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të premtën ka nënshkruar memorandum me Komunën e Zubin Potokut për mbështetje financiare të projektit “Sigurimi i pajisjeve për arenën në Qendrën Sportive në Zubin Potok”, në vlerë prej 100 mijë eurosh. Memorandumin e nënshkruan ministrja Vlora Dumoshi dhe kryetari i komunës, Serxhan Vuloviç. “Ministria ka obligim që të investojë në të gjitha komunat e

Kosovës dhe i trajton të gjitha njësoj. Për mua si ministre të gjitha komunat janë të barabarta, të gjithë janë qytetarët të Kosovës dhe do t’i mbështes të gjitha komunat pa përjashtim. Edhe ky projekt, por edhe projekte të tjera të cilat pritet të planifikohen për vitin e ardhshëm, si MKRS jemi të gatshëm dhe do ta ndihmojmë edhe Komunën e Zubin Potokut”, ka thënë ministrja Dumoshi. Ministrja e njoftoi kryetarin Vuloviç se fondi emergjent prej 5



milionësh për MKRS-në veçse është miratuar dhe e porosit që t’i inkurajojë të rinjtë dhe

organizatat që veprojnë në Zubin Potok, që të aplikojnë në thirrjet që do të shpallen nga ministria,

në mënyrë që të përfitojnë nga fondi. Nga ana e tij, kryetari Vuloviç e falënderoi ministren për pritjen e ngrohtë dhe për mbështetjen. “Mbështetja e ministrisë dhe gatishmëria e ministres për ta ndihmuar Zubin Potokun janë befusuese dhe e mirëseardhur. Është e nevojshme një ndihmë e tillë për komunitetin në Zubin Potok, sepse komuna ka shumë të rinj e sportistë aktivë”, ka thënë Vuloviç. Palët u pajtuan që ditëve në vijim ministrja ta vizitojë Komunën e Zubin Potokut.

## Buruk: Muriqi e meriton transferimin te Lazio

ROMË, 14 GUSHT - Sulmuesi i Përfaqësues së Kosovës, Vedat Muriqi, është duke u kërkuar me ngulm nga Lazio, madje raportohet se tashmë klubet kanë arritur

marrëveshje për shërbimet e 25-vjeçarit për shifrën e 20 milionëve. Lidhur me spekulimet e fundit ka folur edhe ish-trajneri i Muriqit, Okan Buruk. “Muriqi

është shumë i mirë, luftarak dhe i mirë në ajër. Disa vite më parë nuk prisja shumë nga ai, por në këtë moment me punën dhe përkushtimin e ka merituar të

jetë në një klub të mirë në Itali”, u shpreh ai. Sezonin 2019/20, ai ka bërë 36 paraqitje, ka shënuar 17 gola dhe ka dhuruar 7 asistime.



## Torino, pas Hysajt, kërkon edhe Berishën

TORINO, 14 GUSHT - Portieri i Kombëtares së Shqipërisë, Etrit Berisha, është në listën e dëshirave të skuadrës së Torinos. Portieri kuqezi ka bërë një sezon fantastik me SPAL-in, edhe pse nuk mjaftoi që kjo

e fundit të mbijetojë në Serinë A italiane. Së fundmi, mediat pranë skuadrës së Torinos kanë bërë me dije se "Granatat", pas Hysajt, në listë kanë edhe portierin. Me një vlerësim prej 4 milionë eurosh për

kartonin e tij, gardiani kuqezi mund të jetë i dyti në ekipin italian, por një garanci e plotë për skuadrën edhe në rast largimi të Salvatore Sirigusë. Në këtë mënyrë, Berisha duket se rivalizon me Sajmir

Ujkanin. Për këtë të fundit, do të shtohet edhe një herë tjetër rivaliteti me Berishën. Njësoj si në kombëtare, kur ardhja e Etritit si titullar fiks u bë shtytë që Ujkani ta linte Shqipërinë dhe të kalonte te Kosova.



## Drejtuesit e FFK-së pritën përfaqësuesit e gjashtë klubeve



PRISHTINË, 14 GUSHT - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi dhe sekretari i përgjithshëm Eroll Salihu kanë pritur sot përfaqësuesit e klubeve të cilat janë ngjitur një kategori më lart për edicionin e ri 2020/2021: Besa dhe Arbëria si anëtare të reja të Superligës, Kika dhe A&N si anëtare të reja të Ligës së Parë si dhe Vjosa e Dushkaja si anëtare të

reja të Ligës së Dytë. "Kryetari Ademi i përgëzoi këto klube për ngjitjen në një rang më të lartë të garave, duke shprehur shpresën se tani organizimi i tyre do të shënojë ngritje, teksa inkurajoi që të punojnë me vendosmëri për krijimin e kushteve sa më të mira për futbollistët, për të dëshmuar se kanë kapacitetet e nevojshme për ligat në të cilat do të marrin pjesë

dhe kështu t'i shërbejnë edhe ngritjes dhe zhvillimit të mëtejshëm të futbollit në vendin tonë", thuhet në njoftimin e FFK-së. Në anën tjetër, përfaqësuesit e klubeve shprehën respektin maksimal për drejtuesit e FFK-së për kujdesin e treguar ndaj klubeve në periudhën e vështirë të pandemisë, si dhe u zotuan për organizim sa më të mirë në edicionin e ri të garave.

## Spurs, pas 22 vjetësh, nuk kualifikohet në 'play-off'

ORLANDO, 14 GUSHT - U luajtën gjashtë takime radhazi në NBA, në të cilat pritej të jepeshin verdiktet e fundit të sezonit të rregullt. Gjithçka shkoi brenda pritshmërive me fitoret e Portland Trail Blazersit dhe Memphis Grizzliesit, me këtë të fundit që, pas disa javëve në ferr, duhet ta falënderojë Milwaukee Bucksin që nuk u impenjua shumë, duke e pasur mendjen tashmë në "play-off".

Portland Trail Blazersi arriti të triumfojë në frymën e fundit ndaj Brooklyn Netsit me rezultatin 134-133. Në këtë përballje të ekuilibruar dallimin e bëri Damian Lillard që realizoi plot 42 pikë dhe dha 12 asistime, ndërsa në radhët e Netsit spikati me 37 pikë Caris LeVert, që gjithsesi gaboi në gjuajtjen e fundit që do të mund ta siguronte fitoren e skuadrës së tij. Për Blazersin, që e mbylli sezonin e rregullt në vendin e tetë në Perëndim, do të mjaftojë një fitore në dy përplasjet me



Grizzliesin për ta vijuar më tej sezonin.

Memphisi, që shpërdori një avantazh të madh ndaj rivalëve me humbjet e javëve të fundit, vijon mrekullisht rrugëtimin falë suksesit 119-106 ndaj Milwaukee Bucksit, me këtë të fundit që kurseu energjitë, duke mos aktivizuar disa nga elementët kryesorë të skuadrës, ndërsa Giannis Antetokounmpo, për fatin e mirë të Grizzliesit, ishte i shkualifikuar. Spikati me 31 pikë Dillon Brooks, pa harruar ndihmën e jashtëzakonshme të Jonas Valanciunasit, që e mbylli takimin me "triple double": 26 pikë, 19 "rebounde" dhe 12 asistime. Shpresoi deri në fund Phoenix

Suns, që pati një ecuri të pabesueshme në këtë rikthim të NBA-s pas ndërprerjes. Skuadra nga Arizona triumfoi 128-102 ndaj Dallas Mavericksit, por për të shkuar në "play-off" i nevojitej edhe suksesi i Brooklyn Netsit ndaj Blazersit i cili nuk erdhi. San Antonio Spursi u mposhtë 118-112 përballë Utah Jazzit, me tekstanët që dështuan të luajnë në "play-off" pas kualifikimit në 22 edicione radhazi. Në takimet e tjera kishte pak interes. Boston Celticsi "pushoi" ndaj Wizardsit, duke u mposhtur 96-90, ndërsa Los Angeles Lakersi e hoqi këmbën nga gazi, duke u dorëzuar 136-122 ndaj Sacramento Kingsit.

### SHKURT

#### Ajeti: Meritoja më shumë minuta te West Hami

Sulmuesi i Zvicrës, Alban Ajeti, ka dhënë disa komente pas transferimit te skuadra e Celticut. Sulmuesi shqiptar e ka sulmuar ish-skuadrën e vet West Ham United për minutat e pakta që i dhanë në dispozicion. "Po, të them të drejtën meritova të luaja më shumë, nuk duhet ta fshih këtë. E meritoja atë. Por, ky është futbollit, është ashtu siç është. Jam i lumtur tani. Ajo që ka shkuar, ka shkuar dhe tashmë po shikoj përpara", ka thënë Ajeti.

#### Asnjë garë jashtë Evropës, botërori i Moto GP mbyllet me një surprizë

Botërori 2020 i Moto GP do të përfundojë me një garë shtesë, ajo që do të zhvillohet më 22 nëntor, në pistën e Portimao, në Portugali. Lajmin e konfirmoi Dorna, kompania që menaxhon garat e motoçiklizmit. Kalendarin e mëparshëm parashikonte mbylljen e sezonit më 15 nëntor, në Valencia, ashtu sikurse ka qenë gjithnjë traditë. Gjithsesi, Dorna ka siguruar edhe një garë shtesë në Portugali, duke e çuar në 14 numrin total të garave për këtë sezon. Të gjitha garat e këtij sezoni do të zhvillohen në Evropë, duke anuluar të gjitha garat jashtë kontinentit të vjetër. Kalendarin e garave të mbetura të Moto GP (2020): 16 gusht, Spielberg (Austri), 23 gusht Spielberg (Austri), 13 shtator Misano (Itali), 20 shtator Misano (Itali), 27 shtator Barcelona (Spanjë), 11 tetor Le Mansh (Francë), 18 tetor Aragon (Spanjë), 25 tetor Aragon (Spanjë), 8 nëntor Valencia (Spanjë), 15 nëntor Valencia (Spanjë), 22 nëntor Portimao (Portugali).

#### Williani largohet nga Chelsea, prezantohet tek Arsenalit

Willian u largua me parametër zero nga Chelsea, kurse është prezantuar në skuadrën e Arsenalit. Ish-futbollisti i Corinthiansit, Shakhtarit dhe Anzhit do të qëndrojë në Premierë Ligë, kampionat të cilin e ka fituar dy herë në vitet 2015 dhe 2017. Ai do të përpiket t'i tërheqë shokët e tij të rinj të skuadrës drejt titullit që u mungon prej 16 vjetësh "topçinjve". Në CV-në e tij, 32-vjeçari ka një Copa America të fituar me Brazilin, ku numëron 69 paraqitje. Për ironi të fatit, Willian luajti ndeshjen e tij të fundit për Chelsea kundër Arsenalit në finalen e FA Cup, më 1 gusht, të fituar nga ekipi i Artetas. Willian do të përfitojë 220 000 stërlina në javë si futbollist i Arsenalit, skuadër me të cilën ka nënshkruar kontratë trevjeçare.

#### Simeone: Kemi dhënë gjithçka, por kundërshtari kishte entuziazëm dhe freski

Trajneri i Atletico Madridit, Diego Simeone, ka thënë se nuk ka ndonjë arsytim për humbjen ndaj Leipzig (2-1). "Kemi dhënë gjithçka që patëm. Ishte e vështirë për ne që t'i fitonim duelet dhe ishin më të shpejtë. Kishte qenë vit i gjatë me këto 60 ditë pushimi. Pastaj kishte presion për rikthimin në Ligën e Kampionëve. Kishim një javë kohë për t'u kthyer në stërvitje", ka thënë Simeone. "Por, ata kishin përkushtim, entuziazëm dhe freski. Kjo na kushtoi. Nuk ka arsytim", ka shtuar trajneri i Atletico.

#### REZULTATET

Boston Celtics - Washington Wizards	90-96
Los Angeles Lakers - Sacramento Kings	122-136
Memphis Grizzlies - Milwaukee Bucks	119-106
Phoenix Suns - Dallas Mavericks	128-102
Utah Jazz - San Antonio Spurs	118-112
Brooklyn Nets - Portland Trail Blazers	133-134



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj  
Opština Skenderaj  
Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Arsim / Department of Education

Nr. 1601/2020  
Dt: 14.08.2020

Në bazë të Nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, Nenit 5 (shkronja c) të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Rep. së Kosovës Nr. 03/L-068, Nenit 17 (shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Nenit 35 të Ligjit mbi Arsimin Parauniversitar në Rep. e Kosovës Nr. 04/L-032, të UA 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, të UA të MASHT 10/2018 si dhe në bazë të kërkesave të institucioneve arsimore, Drejtoria Komunale e Arsimit në Skenderaj, shpall:

**Konkurs për plotësimin e vendeve të lira të punës për vitin shkollor 2020/2021**

Nr.	Niveli	Pozita	Institucioni	Vendi	Pensionim / Zëvendësim	Nr. i orëve	Nr. i pozita ve
1.	Shfmu	Mësimdhënës/e për Mësim klasor	"Elena Gjika"	Makërmal	Zëvendësim	Normë e plotë	1
2.	Shfmu	Mësimdhënës/e për Mësim klasor	"Pavarësia"	Baks	Vend i lirë	Normë e plotë	1
3.	Shfmu	Mësimdhënës/e për lëndën Gjuhë Angleze	"Azem Bejta"	Prekaz i Epërm	Zëvendësim	Normë e plotë	1
4.	Shfmu	Mësimdhënës/e për lëndën Gjeografi	"Azem Bejta" "Ilir Lushtaku"	Prekaz i Epërm Prekaz i Poshtëm	Vend i lirë	Normë e plotë	1
5.	Shfmu	Mësimdhënës/e për Mësim klasor	"Idriz Barani"	Terrnac	Vend i lirë	Normë e plotë	1
6.	Shfmu	Mësimdhënës/e për Mësim klasor	"Ahmet Delija"	Skenderaj	Zëvendësim	Normë e plotë	1
7.	Shfmu	Mësimdhënës/e për lëndën Gjeografi	"Ahmet Delija"	Skenderaj	Vend i lirë	Normë e plotë	1
8.	Shfmu	Mësimdhënës/e për lëndën Edukatë Fizike	"Shotë Galica"	Runik	Vend i lirë	Normë e plotë	1
9.	Shfmu	Mësimdhënës/e për Mësim klasor	"Halit Geci"	Llaushë	Zëvendësim	Normë e plotë	1
10.	Shfmu	Mësimdhënës/e për lëndën Kimi	"Abedin Rexha"	Turiqec	Zëvendësim	Normë e plotë	1
11.	Shfmu	Mësimdhënës/e për Mësim klasor	"Shaban Jashari"	Skenderaj	Vend i lirë	Normë e plotë	1
12.	Shfmu	Mësimdhënës/e për Mësim klasor	"Dëshmorët e Qyqanicës"	Qirez	Zëvendësim	Normë e plotë	1
12.	Shfmu	Mësimdhënës/e për Gjuhë gjermane	Disa shkolla		Vend i lirë	Normë e plotë	3
13.	Shmlp	Mjek i përgjithshëm	"Anton Çetta"	Skenderaj	Vend i lirë	Normë e plotë	2
14	Shmlp	Farmacist	"Anton Çetta"	Skenderaj	Vend i lirë	Normë e plotë	2

**Kushtet:** Për të gjitha vendet e punës, në të tri nivelet (shkolla fillore, shkolla të mesme të ulëta dhe shkolla të mesme të larta) kandidatët duhet t'ia kenë të kryer fakultetin - drejtimi përkatës sipas Normativit 10/2018, ndërsa në mungesë të kësaj kualifikimi vijonë kandidatët e tjerë, të drejtimit të përkatës, që i plotësojnë kushtet më së miri. Zgjedhja e kandidatëve për mësimdhënës do të bëhet në bazë të nenit 35 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, UA 10/2018 si dhe në bazë të rezultateve të panel-intervistës, me shkrim dhe me gojë. Për intervistën me gojë dhe me shkrim do të ftoheshin vetëm kandidatët e listës së ngushtë, sipas nenit 4 të UA 17/2009. Kandidatët e listës së ngushtë me shkrim dhe me gojë do të ftoheshin në telefon.

Për konkurrim, kandidatët duhet të plotësojnë dokumentacionin:

- ❖ Kopje e vërtetuar e diplomës;
- ❖ Kopja e letërmbajtimit;
- ❖ Vërtetimin për punë nga gjykatat;
- ❖ Certifikatën e gjendjes shëndetësore (në rast se pranohet);
- ❖ Certifikatë trajnimi - nëse keni;
- ❖ Përvoja e punës - nëse keni;
- ❖ Referencën e punës ata që kanë përvojë pune;

Aplikacioni merret dhe dorëzohet në objektin e Komunës, kati i parë, sporteli nr. 13;

Kandidatët mund të konkurrojnë me së shumti në dy shkolla;

Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomën e nostrifikuara nga MASHT.

Fillimi i punës për vendet e lartcekura, nuk do të jetë domosdoshmërisht pas shpalljes së rezultateve, por varet sipas vendit të punës në shkollë (datës së pensionimit apo pushimit të lehonisë etj.).

Dokumentet e pakompletuara si dhe ato pas afatit, nuk merren në shqyrtim.

Rezultatet e konkursit do të shpallen në webfaqe të Komunës së Skenderajt.

Dokumentacioni nuk kthehet.

Afati i konkursit mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit të konkursit në gazetë dhe në webfaqen zyrtare të Komunës së Skenderajt.

Drejtoria Komunale e Arsimit  
Skenderaj

Ministria e Arsimit dhe Shkencës duke u bazuar në Vendimin të Ministrit nr. XX XX të datës XX XX :



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada-Government  
Ministria e Arsimit dhe Shkencës / Ministarstvo za Obrazovanje i Nauku / Ministry of Education and Science

**SHPALL KONKURS**

PËR NDARJE TË 40 BURSIVE PËR FEMRA PËR REGJISTRIM NË DREJTIME TEKNIKE NË INSTITUCIONE TË ARSIMIT DHE AFTËSIMIT PROFESIONAL PËR VITIN SHKOLLOR 2020-2021

**Realizimi i të drejtës për bursë për drejtime teknike**

Të gjitha femrat të cilat përfundojnë shkollimin e mesëm të ulët, të cilat i plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuar në konkurs kanë të drejtë të aplikojnë për bursë në një nga drejtimet teknike në të gjitha IAAP-të në Republikën e Kosovë të cilat ofrojnë një nga profilet në vijim:

1. Instalues i ngrohjes, klimatizimit dhe ujësjellësit;
2. Instalues elektrik;
3. Mekatronikë; dhe
4. Automekanik.

**Kushtet dhe kriteret**

1. Për fitimin e bursës së MASH, kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte dhe kriteret bazë:
  - 1.1. Të jenë shtetase të Republikës së Kosovës;
  - 1.2. Suksesi i shkollimit paraprak – klasat 6 – 9.

**Dokumentacioni që kërkohet për aplikueset:**

1. Kërkesë për bursë, duke cekur edhe drejtimin për të cilin aplikon;
2. Certifikatën e shkollës së mesme të ulët;
3. Suksesi për klasët 6 - 9;
4. Certifikatën e lindjes.

**Procedurat e aplikimit**

- Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentacionit bëhet në IAAP;
- Drejtorët e IAAP-ve i dorëzojnë aplikacionet në MASH më 28 Gusht 2020;
- Dokumentet e pakompletuara nuk shqyrtohen.

**Konkursi do të jetë i hapur prej 17 deri 27 Gusht 2020.**

**E drejta e ankesës:** Kandidatët që kanë aplikuar për përfitim të bursës, kanë të drejtë ankese në afat prej 3 (tri) ditësh, pas shpalljes së rezultateve. Ankesat dorëzohen në arkivin e MASH, kati përderes, zyra nr. 4 dhe shqyrtohen nga Komisioni për ankesa dhe parashtrësia i MASH.

Adresa: Agim Ramadani p.n. 10.000 Prishtinë-Kosovë

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

**Kërkoj një pastruese për shtëpi. Shtëpi është në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Informatat në tel: 045-336-731**

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit me qira. Lokalit është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokalit gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Çlirim Musa shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Medreseja "Alauddin" Prishtinë.


► Albana Ballazhi Qerimi shpalle te pavlefshme diplomën e Sh.M.L "Dardania" Hani Elezit.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**OIK**

**Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës**  
**Komora medicinskoh sestrara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova**  
**The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professional**

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, Udhëzimit Administrativ Nr. 14/2011 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik, Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 05/2014 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr.14/2011, Në bazë të nenit 20 pika 1.6 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor Nr.04/L. /150 dhe nenit 23 pika 1.6 të Statutit të OIK-ut, vendimit të Këshillit Drejtues të Odës të datës 13.02.2018 dhe mbështetur në Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës të shërbimit profesional me Nr.Prot.55/2 të OIK-ut, OIK shpallë këtë:

### KONKURS

Për këto pozita të punës:

**I. Titulli i vendit të punës:** Zyrtarë i lartë ligjorë

**Norma e punës:** Orar i plotë (40 orë pune në javë)  
**Kontrata:** Sipas legjislacionit në fuqi  
**Raporton:** Kryetarit të OIK-ut  
**Nr. i zyrtarëve:** Një (1) Pozitë.

**Përshkrimi i detyrave të punës:**

- Harton vendimet që kanë të bëjnë me punëtorët;
- Harton vendime të ndryshme të cilat i lëshon OIK-u ose lidhen me punën e OIK-ut;
- Harton kontratat e punës;
- Siguron ofrimin e vazhdueshëm të asistencës ligjore dhe juridike për njohjen më të mirë, kuptimin dhe zbatimin e legjislacionit në fushën e Infermierëve.
- Kontribon në zgjidhjen e kërkesave për gjetjen e opsioneve dhe hapësirave ligjore mbi problemet që parashtohen në rrugë administrative.
- Përditëson periodikisht shtesat dhe ndryshimet e legjislacionit në fuqi, në fushën e Infermierëve për një mbarëvajtje më të mirë të punës të Kryetarit të OIK;
- Bën interpretim juridik të akteve ligjore, nënligjore për zgjidhjen e problematikave në sektorin infermior;
- Shqyrton dhe harton përgjigjet e kërkesave dhe ankesave të OIK;
- Siguron ndihmën juridike për veprimtarinë e të gjithë OIK;
- Përfaqëson dhe mbrojnë interesat e OIK dhe me urdhrë të Kryetarit të OIK, përfaqëson OIK në proceset gjyqësore;
- Verifikon përputhshmërinë ligjore për të gjitha shkresat e përgatitura në zyrë të OIK. Përgatit argumentet e tij për kërkesë/ankesat e infermierëve të drejtuara pranë OIK, dhe i paraqet pranë Kryetarit të OIK;
- Kur për zgjidhjen e kërkesave nevojiten të dhëna nga sektoret e tjerë të OIK, kërkon bashkëpunimin e tyre në trajtimin e problemit;
- Përgatit dhe dërgon në komisionin e disiplinimit të gjitha çështjet e drejtuara këtij komisioni së bashku me relacionet shpjeguese përkatëse;
- Shqyrton dhe merr vendimin për ankimet e paraqitura nga infermierët dhe personat tjerë duke i bazuar ato në provat dhe argumentet e paraqitura;
- I përgjigjet Sekretarit të Përgjithshëm të OIK-ut;
- Kryen edhe punë të tjera zyrtare të kërkuara sipas udhëheqësit.

**Shkollimi i kërkuar:**

- ✓ Fakultet Juridik,
- ✓ 2 (dy) vite përvojë pune.

**Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:**

- ✓ Diploma e Fakultetit Juridik.
- ✓ Dokumenti i identifikimit (Letërnjoftimi) kopje.
- ✓ Dëshmi për përvojën e punës.

**Aftësitë / përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:**

- ✓ Të ketë shkathtësi të dëshmuara dhe efektive të komunikimit me shkrim dhe me gojë.
- ✓ Të ketë njohuri të gjuhëve zyrtare në përdorim;
- ✓ Njohja e punës me kompjuter është e domosdoshme.

**Kushtet e pjesëmarrjes në konkurës:**  
Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, të ketë mbaruar shkollimin adekuat për pozitën e shpallura si dhe të ketë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

**Procedurat e konkurrimit:** Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

**Data e mbylljes së konkursit: 15 ditë nga data e publikimit në mjetet e informimit.**

**Paraqitja e kërkesave:** Aplikacionet merren, plotësohet dhe dorëzohen çdo ditë pune nga ora 09:00-14:00 në zyrë të OIK-ut.


**Adresa:** Rruga "Holger Pedersen" mbrapa QKUK-së kompleksi banesor Vëllezërit Asllani.

Të gjitha dokumentet dhe dëshmitë profesionale t'i bashkëngjiten aplikacionit.

Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së konkursit dhe kërkesat e pa kompletuara nuk do të pranohen.

Kandidatët të cilët aplikojnë, të ofrojnë dëshmitë sipas konkursit të shpallur, për ndryshe kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të thirren për intervistim.

Prishtinë,  
Datë: 14.08.2020



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



**facebook**  [www.facebook.com/gjejpuneshpejite](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejite)

## RESTAURANT

---


# SWISS

## TAVERNA

---


Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553


PRISHTINË





# Lume's Details


## Estetik & Depilim



 044 900 978 | 045 681 898

 Sallon Depilimi Lume's Details

 lumesdetails

 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi